



UBT NEWS

Gazetë e studentëve të Universitetit për Biznes dhe Teknologji | Tetor-Nëntor 2011

POLITICS • ECONOMY • BUSINESS • TECHNOLOGY • EDUCATION • SCIENCE • CULTURE

NGA UBT NË VENDE TË BE-së

Studentët e UBT-së fituan bursa studimi në 16 universitete të vendeve të BE-së **Faqe 10**



NGA UBT NË SHBA

Faqe 2

NGA UBT KANË DALË EKSPERTË TË MIRË

Kurrikulat tona janë kompatible me ato të shteteve të UE-së. Kosova si dhe të gjitha shtetet e rajonit kanë ambicie të jenë pjesë e UE-së, prandaj gjatë hartimit të Kurrikulës kemi pas parasysh edhe këtë fakt. **Faqe 8**

TË STUDIOSH "PRANË UNIVERZITETIT" DHE TË PUNOSH "PRANË ÇEVERISË"!

Nuk është gjysma e shekullit të kaluar. Është viti 2011. Kosova është shtet...

Faqe 12-13



REVISTA SHKENCORE E UBT EVETMJA ME NUMËRTË ISSN

Faqe 15

DHJETË VJET



Faqe 4-5

SOLEMNISHT NISI VITI I RI AKADEMIK NË UBT

Me një ceremoni solemne më 5 tetor është hapur viti i ri akademik 2011/2012 në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Në ceremoni morën pjesë, Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, dhe dekanët e njësive akademike, profesorët, studentët e rinj si dhe familjarët e tyre. Presidenti i UBT-se, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, u ka dëshiruar mirëseardhje studenteve të rinj në botën akademike universitare, duke shprehur bindjen se ata që nga dita e parë do të angazhohen me intensitet të plotë për të nxënë dijet e reja, rrugë në të cilën UBT do t'i ndihmoj me të gjitha kapacitetet e tij.

Faqe 6-7



Editorial

DHJETË VJET LEADERSHIP DHE INOVACION

Dhjetë vjet më parë, në vitin 2001, Instituti për Menaxhim të Ndërmarrjeve dhe Inxhinierg (IEME) u themelua si institut shkencor dhe profesional për ofrimin e edukimit, trajnimeve, hulumtimeve dhe konsultimeve në fusha të ndryshme të biznesit dhe teknologjisë.

Si rezultat i punës së suksesshme të tij u themelua Universiteti për Biznes dhe Teknologji.

Të dy këto institucione, që tash funksionojnë së bashku, u themeluan dhe udhëhiqen nga Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i cili përvojën e tij nga studimet dhe mësimdhënia në Universitetin e Vjenës e solli dhe po e zbaton me shumë sukses në Kosovë.

Në një kohë kur ishte vështirë të sigurohen kushte për funksionimin e një instituti e sidomos të funksionimit të një universiteti, i pari privat në vendin tonë, themeluesi i këtyre dy institucioneve, z.Hajrizi nisi projektin e tij, pa zhurmë por me rezultate të shpejta dhe të dukshme e të respektuara nga të gjithë në vend dhe më gjerë.

Shikuar dhjetë vjet më pas, lirisht mund të themi se UBT është krijuar dhe është zhvilluar në një universitet ndërkombëtar; një universitet modern, që i përmbush nevojat e një shoqërie dhe vendi demokratik, që në vazhdimësi është duke i zhvilluar kapacitetet ekonomike dhe teknologjike.

UBT është universitet inovativ në Kosovë dhe regjion dhe ngërthen në vete të gjitha përparësitë e universiteteve të njohura ndërkombëtare: programe bashkëkohore të studimeve të licencuara dhe akredituara në përputhje me standardet ndërkombëtare të kualitetit; diploma ndërkombëtarisht të pranuar; akademikë dhe ekspertë eminentë; partneritet me universitete dhe institucione të njohura nga BE dhe SHBA; mundësi të eksperiencës jashtë vendit (studime profesionale dhe praktikë); infrastrukturë moderne; menaxhimi dhe organizimi i universitetit (në përputhje me ISO 9001); lidhje direkte me komunitetin e biznesit; projekte hulumtuese akademike me karakter ndërkombëtar; transferim të know-how; si dhe staf akademik, administrativ dhe studentë shumë të motivuar që e bëjnë UBT-në një universitet modern në Evropë.

Në këtë dhjetëvjetësh të madh për ne të gjithë, themi me mburrje se UBT, përveç misionit të tij primar në përgatitjen e kadrove të reja, ka arritur rezultate të pamohueshme në shumë fusha, është bërë dritare e Kosovës në botë, duke e anëtarësuar vendin tonë në shumë institucione ndërkombëtare, ku as vendet e rajonit nuk janë të anëtarësuar, në organizimin e garave me karakter ndërkombëtar në Prishtinë, duke qenë i pari në vend e në rajon, duke sjellë në Kosovë profesorët më eminentë nga e gjithë bota dhe duke siguruar atë që është më e rëndësishmja – shkallën shumë të lartë të punësimit të të diplomuarve, rritjen e përditshme të shkallës së besimit dhe respektit të studentëve, prindërve dhe opinionit në përgjithësi për punën dhe rezultatet e UBT-së, si dhe shkallën më të lartë të bashkëpunimit ndërkombëtar me institucione e universitete ndërkombëtare.



IMPRESUM

UBT News - Gazetë e studentëve të UBT-së,
Përgatiti & Kryeredaktore: Naile Demiri
Adresa: www.ubt-uni.net
Tel: 038 541 400
Thyerja Grafike: ELV Studio



**UNIVERSITY EDUCATION
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY**
AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

NISI IMPLEMENTIMI I MARRËVESHJE SË BASHKËPUNIMIT MES UNIVERSITETIT PËR BIZNES DHE TEKNOLOGJI (UBT) DHE UNIVERSITETIT CITY

NGA UBT STUDIMET VAZHDOHEN NË UNIVERSITETIN CITY NË LONDËR

“Nga ky vit i ri akademik 2011-2012 po edhe në vitet në vazhdim studentët e UBT-së mund të vazhdojnë studimet universitare në universitetin City në Londër, më të njëjtën shumë dhe pagesë” u tha gjatë takimit të Presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi me menaxhemntin më të lartë të Universitetit City në Londër të Anglisë.

PRISHTINË, 10 TETOR 2011- Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) Prof. Dr. Edmond Hajrizi, qëndroi për vizitë disaditëshe në Londër të Anglisë, pikërisht në Universitetin City, dhe aty zhvilloi disa takime me menaxhmentin më të lartë të këtij Universitetit.

Më konkretisht të dyja palët diskutuan rreth nisjes së impelmentimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndëruniversitar që është nënshkruar dhe zyrta-



rizuar po në fillim të këtij viti në objektin e Universitetit City.

Me theks të veçantë marrëveshja në fjalë u mundëson

studenteve kosovarë, pikërisht studentëve të UBT-së që studimet universitare të vazhdojnë në Universitetin City dhe të marrin

diplomën e tyre, më konkretisht nga ky vit i ri akademik 2011-2012 po edhe në vitet në vazhdim studentët e UBT-së mund të va-

zhdojnë studimet në universitetin City në Londër, më të njëjtën shumë dhe pagesë.

Po ashtu marrëveshja do ofrojë edhe programe të tjera të veçante si janë projektet, seminarët, transferi i teknologjisë, shkëmbimin e literaturës më të avancuar, dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet.

Në bazë të bisedave që patën mes udhëheqësit e institucioneve në fjalë Presidenti i UBT-së Dr. Hajrizi, dhe prodekani Prof. Dr. Sanawar Khan u ndan të kënaqur me nisjen e implementimit të marrëveshjes në fjalë.

Universiteti City numëron një numër të konsiderueshëm të mësimit dhe ka marrëveshje shumta bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare, është themeluar që 100 vite e më shumë, numri i të diplomuarve është i krahasueshëm me universitetet më të mëdha në botë, po ashtu të diplomuarit sot janë në vende udhëheqëse nëpër kompani dhe organizata më profitabile në Evropë dhe botë.

STUDIME MASTER NË UNIVERSITETIN RUTGERS NË SHBA



FESTIM BAJGORA, STUDENT NË UBT

Rrezarta Veseli, në vitin 2009 ka përfunduar studimet Bachelor në Fakultetin Shkencë Politike në UBT. Ende pa përfunduar studimet, Rrezarta përzgjidhet si

finaliste në grupin e tetë studentëve nga Kosova për studime dy vjeçar Master në SHBA me bursë nga KAEF – Kosovo American Education Fond, dhe vijon studimet Master në shkollën Edward J. Bloustein për Planifikim dhe

Politika Publike në Universitetin Rutgers, në kampusin e New Brunswick, New Jersey. Punimi i diplomës ka qenë i mentoruar nga këshilltarja e saj akademike Dr. Julia Rubin.

Pas diplomimit fillon punën në New Jersey Community Capital, një institucion financiar me bazë në kryeqytetin e New Jersey, ku punon edhe sot. Ajo është përgjegjëse për koordinimin e vlerësimit të projekteve.

Jashtë sferës akademike, Rrezarta ka kryer praktikën në zyrat globale të UNICEF-it në New York. Ajo po ashtu ka qenë anëtare aktive në Shoqatën e Studentëve të nivelit Master në Universitetin Rutgers, ku ka pasur rastin të llojoj me Senat dhe Shtëpi të Përfaqësuesve për ngritjen e buxhetit Federal për hulumtime shkencore dhe sociale në nivel universitar.

Në fund të vitit 2012, ajo planifikon të kthehet në Kosovë dhe ta fillojë aplikimin e njohurive dhe shkathësive të fituara gjatë studimeve dhe përvojës së punës në SHBA, ku mendon të angazhohet në hulumtimin e politikave sociale dhe shfrytëzimin e rezultateve për të informuar alokimin adekuat të buxhetit, si dhe zhvillimin e politikave që promovojnë aktivitetet e shtuar ekonomik, dhe përkrahje për edukim dhe trajnim të vazhdueshëm të punëkërkuarëve.

NGA UBT NË ITALI E MË PAS NË FRANCË



Leana Mahmuti e cila para tre vjetëve i ka përfunduar studimet themelore në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Fakulteti Arkitekturë, kurse studimet për master jo në UBT por në Universitetin "Politecnico Di Milano" në Republikën e Italisë, drejtimi Arkitekturë, dhe diplomon me temën "Projekti urbanistik dhe arkitektonik në qytetin e Barcelonës".

"Kryesisht është dashur të bëhen analiza e qytetit duke filluar nga aspekti urbanistik e deri te ai social. Për propozimin e një master plani është dashur të vendosen kriteret urbanistike, të shpjegohen arsyet dhe metodat e shtjellitimit të projektit, ndërsa në fund është përcaktuar hapësira urbanistike për ndërtimin e objekteve kulturore dhe hapësirave publike", tha znj. Leana, për gazetën "UBT News". Ajo më tej citon se pas këtyre analizave dhe shtjellitimeve ideore janë projektuar pjesët më të rëndësishme arkitektonike ku i gjejmë në temë në fjalë.

Pas përfundimit të studimeve Leana shkon në Francë dhe menjëherë punësohet në një zyre të arkitekturës në qendër të Parisit, "Park & Asocies", ku përveç punës merret edhe me aktivitete tjera, më konkretisht është duke e përvetësuar gjuhën frënge në një shkollë të gjuhëve në Paris.

DHJETË VJET



Të nderuar studentë, profesorë, kolegë, prindër, partnerë akademikë dhe inswtitucionalë të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Më lejoni t'ju uroj përvjetorin e dhjetë të punës së IEME-s dhe UBT-së.

Më 2001 kemi filluar punën me qëllim të zhvillimit të kompetencës profesionale dhe akademike, konform standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, me qëllim të ngritjes së aftësisë konkurruese, zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe integriteteve ndërkombëtare.

Nevoja për një lider profesional është kërkesë e përditshme.

Kjo nënkupton se për ata që e njohin mirë profesionin, perspektiva e tyre është e hapur në tërë botën.

Ne po punojmë çdo ditë që të zhvillojmë një personalitet, i cili është shumë i përgatitur profesionalisht, është i përkushtuar në punë, ka shkallë të lartë kreativiteti dhe inovacioni, ndërton partneritet me të tjerët, ndihmon veten dhe shoqërinë, puna e tij bazohet në fakte dhe në rezultate, ka një aftësi të lartë ndërkulturore dhe interdisiplinare, por ka

edhe një komunikim modern të bazuar në vlerat më të larta.

Pra, puna në UBT ka pasur dhe ka pikërisht qëllim: ofrimin e vglave dhe aftësive të nevojshme, për të marrë vendime racionale që garantojnë suksese dhe rezultate që bazohen në vlerat më të larta akademike, profesionale dhe njerëzore.

UBT është në shërbim të atyre që duan që përmes studimeve, hulumtimeve, trajnimeve dhe konsultimeve të përfitojnë dhe të rrisin prestigjin e tyre në shoqëri, të jenë të suksesshëm në profesionin e tyre, si dhe të krijojnë dhe të përjetojnë një jetë me cilësi dhe vlera.

Detyra kryesore e jona është që t'i ofrojmë arritjet e fundit në shkencën e menaxhimit, në ekselencën biznesore, në teknologjinë më moderne, në robotikë, në arkitekturë, në dizajn, planifikim hapësinor, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, në drejtësi, në integritet evropiane, por edhe në kompetencën sociale.

Universiteti për Biznes dhe Teknologji është themeluar me qëllim që të jetë një universitet lider dhe inovativ në vend.

Studimet e reja, interdisiplinare dhe inovative, një staf akademik i përzgjedhur me shumë kujdes nga e tërë bota, laboratorët dhe infrastruktura moderne, partneriteti me universitete dhe institucione akademike, ndërlidhja e fortë me ekonominë, institutet shkencore dhe hulumtuese, qendrat e ekselencës, suksesi i arritur i studentëve tanë në punësim, në përfaqësimin e Kosovës në kampionate evropiane, në konkurrim me planet dhe idetë e tyre inovative në biznes dhe teknologji, pjesëmarrja aktive në forume dhe konferenca ndërkombëtare, janë shembujt dhe dëshmitë më të mira për këtë.

Ky pozicion i UBT-së vjen si rezultat:

... i një përkushtimi disavjeçar të studentëve, për të studiuar dhe për të ndërtuar një dije dhe një personalitet lideri në njërin prej profesioneve të zgjedhura, me qëllim të arritjes së një cilësie më të lartë jetësore për vete dhe për shoqërinë.

Nuk është i rastësishëm edhe slogani ynë tanimë i njohur *"Top University for Top Students"*

Pjesa e parë e sloganit nuk ka kuptim pa pjesën e dytë....

... i një planprogrami modern që e kemi disenuar dhe zhvilluar me vite, duke u bazuar në standardet evropiane dhe amerikane të studimeve, por edhe në bazë të nevojave dhe kërkesave që dalin nga tregu i punës në vend.

Planprogramet e studimeve janë të disenuara në atë mënyrë që t'i ndërlidhin dy shkollat më të njohura për nga cilësia në botë: shkollën evropiane dhe atë amerikane.

Studentët tanë studiojnë me planprograme që janë të njëjta me të atyre që studiojnë në Detroit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me ata të Vjenës në Austri, apo me ata të Waterfordit në Irlandë, sepse së bashku me këto universitete partnere dhe të tjera ne kemi krijuar kurikulën tonë të re dhe moderne.

Janë krijuar dhe ofruar programe të reja studimesh me karakter interdisiplinar për nevojat e shoqërisë:

- International Engineering Management
- Architecture, Spatial Planning and Project Management
- Law, Political Science and Diplomacy
- European Integration and Law
- Public Procurement and Management

- Software and System Engineering,
- Management, Business and Technology, etj.

... i një angazhimi të një stafi akademik të përzgjedhur mirë e mirë dhe me shumë kujdes, me një eksperiencë të lartë ndërkombëtare, si në shkencë ashtu edhe në aspektin profesional.

Më shumë se 300 profesorë dhe ekspertë, nga katër kontinente, nga 20 vende dhe kultura të ndryshme, nga rreth 60 universitete dhe institucione partnere me renome botërore, kanë sjellë dhe po vazhdojnë të sjellin në UBT përvojën dhe dijen e tyre në programet dhe projektet tona.

Në UBT mund të keni rast të takoni studentë, profesorë, ekspertë, diplomatë... nga e gjithë bota.

Kjo ka krijuar një ambient unik ndërkombëtar, ndërkulturore dhe interdisiplinar jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë.

Gjate këtyre 10 viteve, puna dhe studimet janë organizuar në gjuhën shqipe, gjuhën angleze, në gjuhën gjermane dhe atë frënge.

... i një sistemi modern të menaxhimit. Ne në UBT kemi disenuar një sistem menaxhimi, i cili

në vete ngërthen praktikat më të mira të universiteteve prestigjioze në botë, të standardeve ndërkombëtare, të koncepteve moderne, duke mos harruar edhe faktorët realë të ambientit ku vepron, ashtu që ky universitet (sistem) i ri të jetë sa më cilësor, sa më fleksibil, sa më kreativ dhe inovativ.

Gjatë ndërtimit të këtij sistemi është dashur patjetër të merren parasysh risitë që sjell ky sistem në vend dhe jashtë vendit, si në aspektin profesional, funksional, por dhe atë ekonomik.

... po ashtu edhe për arsye se UBT, përveç të tjerash:

- Prej fillimit të punës ka aplikuar dhe ka fituar projekte të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkimit Evropian,

- Përfaqëson Kosovën në Projektin Evropian "Erasmus Mundus", ku 39 mobilitete janë zhvilluar me universitetet evropiane

- Është institucioni i parë dhe i vetmi deri tash që është certifikuar ndërkombëtarisht me standardin ndërkombëtar për cilësi ISO 9001

- Ka përfaqësuar Kosovën dhe ka zënë vendin e parë në garat e robotikës në Evropë

- E ka anëtarësuar dhe përfaqëson Kosovën në Organizatën Botërore për Menaxhimin e Projekteve

- E ka anëtarësuar dhe e përfaqëson Kosovën në Organizatën Evropiane për Cilësi

- E ka anëtarësuar Kosovën dhe e përfaqëson atë në Organizatën Botërore për Inxhinieri

- E përfaqëson Kosovën në Programin Evropian për Ndërmarrësi

- Ka organizuar disa herë me radhë në vend konferenca të nivelit shkencor dhe botëror,

- Ka zhvilluar Laboratorin modern të Teknologjisë dhe të Robotikës

- Ka zhvilluar institutin e hulumtimeve dhe zhvillimeve zhvillim ekonomik, për ndërmarrësi, teknologji dhe inovacione

- Ka marrëveshje bashkëpunimi me mbi 60 universitete dhe institucione në botë dhe një lidhje direkte me ekonominë

- Aftëson dhe certifikon personat sipas standardeve ndërkombëtare

- Organizon vizita studimore për studentë, institucione dhe biznese

- Zhvilluar strategji, projekte dhe hulumtime për institucione dhe sektorë të ndryshëm të shoqërisë

... se UBT vazhdimisht është:

• duke investuar në infrastrukturë dhe teknologji

• duke rritur dhe profesionalizuar personelin akademik dhe administrativ

• duke rritur numrin e projekteve, hulumtimeve, publikimeve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare

• duke rritur partneritetin me ekonominë për të mundësuar realizimin e praktikave gjatë studimit dhe punësimit

• duke përmirësuar proceset tona në aspektin akademik dhe organizativ duke përdorur metodat dhe teknologjitë më të reja

• kemi bërë dhe bëjmë edhe shumë punë të tjera për çdo

ditë në mënyrë që sukcesi të jetë i garantuar.

Përpos rezultateve dhe sukseseve gjatë këtyre 10 viteve, IEME – UBT ka kaluar edhe nëpër shumë sfida.

Shpeshherë kemi përshtypjen se ne kemi bërë një punë pioniere, e cila i ka dhënë rezultatet e veta.

Dhe ky sukses vjen si rezultat i punës së madhe dhe të palodhshme të të gjithëve neve.

Me këtë rast, dua të falënderoj udhëheqjen e UBT-së, fakultetet, departamentet, personelin, studentët, ambasadorët e UBT-së, partnerët, institucionet dhe individët e tjerë të involvuar me orë, muaj dhe vite të tëra për të bërë këtë dekadë pune të suksesshme.

Personalisht më duhet të falënderoj shumë edhe familjen time, pa përkrahjen e së cilës nuk kisha pasur mundësi të angazhohem në një projekt shumë kompleks dhe me përgjegjësi të lartë pro-

fesionale, juridike dhe financiare. Universiteti është një sistem multidisiplinar dhe shumë kompleks.

Të dizajnosha dhe të menaxhosh një sistem të tillë prej fillimit ishte vërtet një sfidë e madhe. Megjithatë, ishte dhe mbetet motivi ynë për të kaluar/shtyrë kufirin e vlerave akademike, shkencore dhe profesionale.

Në këtë mënyrë ne do të vazhdojmë të punojmë dhe bashkëpunojmë ngushtë për të mbështetur një zhvillim dhe një rritje të qëndrueshme profesionale, duke e përkrahur ekselencën, inovacionin, teknologjitë moderne, interkulturalitetin, zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe duke kultivuar kulturën dhe vlerat më të larta kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare.

URIME!

Prof. Dr. Edmond Hajrizi,
Themelues dhe President



UNIVERSITETI PËR BIZNES DHE TEKNOLOGJI E KA FILLUAR VITIN E RI AKADEMIK 2011-2012

SOLEMNISHT NISI VITI

PRISHTINË, 5 TETOR 2011-
Me një ceremoni solemne më 5 tetor është hapur viti i ri akademik 2011/2012 në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Në ceremoni morën pjesë, Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, dhe dekanët e njësive akademike, profesorët, studentët e rinj si dhe familjarët e tyre.

Presidenti i UBT-se, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, u ka dëshiruar mirëseardhje studenteve të rinj në botën akademike universitare, duke shprehur bindjen se ata që nga dita e parë do të angazhohen me intensitet të plotë për të nxënë dijet e reja, rrugë në të cilën UBT do t'i ndihmoj me te gjitha kapacitetet e tij.

Me këtë rast Presidenti i UBT-së, z. Hajrizi i ka prezantuar të arriturat dhe planet për të ardhmen e Universiteti duke e cekur ngritjen e UBT-së në të gjitha sektorët e veçanërisht atë të cilësisë në studime dhe krijimin e kushteve brenda UBT-së.

Po ashtu studentëve u uroj suksese në të ardhmen dhe kërkoi nga ta dhe nga stafi akademik angazhim dhe punë konkrete.

Një fjalë rasti në këtë ceremoni, ndërlidhur me punën hulumtuese dhe studimore dhe rezultatet e arritura në UBT, e ka mbajtur edhe Drejtori për çështje akademike Dr. Binak Beqaj.

Në ceremoninë e pritjes së studentëve të rinj me një fjalë u paraqitën edhe dekanët e të gjitha Fakulteteve të UBT-së. Ata përkujtuan se në këtë vit të ri akademik 2011/2012 në UBT ka rritje të programeve akademike dhe po ashtu për



studimet në këto njësi janë përcaktuar një numër i madh i studenteve të rinj krahasuar

me vitin e kaluar, dhe me ta do punojnë një numër i madh profesorësh vendore e

ndërkombëtare, eksperte të fakulteteve të përzgjedhura, ndërkohë që studentet do

te kenë në dispozicion salla, kompjuter, laboratorët etj. Po kështu, si një faktor shumë po-



I RI AKADEMIK NË UBT



zitiv, u përmendën edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete më prestigjioze në

botë dhe Evropë, dhe lëvizjen e studentëve në këto universitete për vazhdimin e studimeve

të mëtutjeshme dhe njohja e diplomave ndërkombëtarisht, dhe bashkëpunimin me kom-

panitë më të rëndësishme në vend dhe më gjerë, që studentëve do të mundësojnë zhvillimin në nivel sa më të mirë të punës praktike dhe punësimit të mëtutjeshëm.

Poashtu Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi citoi se "Ky është viti i nëntë që UBT-ja organizon një ceremoni të tillë për fillimin e vitit të ri akademik.

Ceremoni të tilla të organizuar në vazhdimësi, del si rezultat i punës së palodhshme me një program modern që UBT-ja e ka filluar me vite, duke u bazuar në standarde evropiane dhe amerikane të studimeve po edhe në bazë të nevojave dhe kërkesat që dalin nga tregu i punës".

Ai më tej shtoi se kjo ceremoni sot ekziston falë vendimit të juaj që Ju të jeni pjesë e këtij institucioni.

Natyrisht në UBT është krijuar një ambient unik në Kosovë, një ambient ndërkombëtar, ndërkulturore, interdisiplinar, dhe kjo i ka krijuar UBT-së një mundësi për programe dhe studime dhe projekte që nuk kanë qenë në shumicën e rasteve më pare të ofruar fare në Kosovë, tha z. Hajrizi.

Presidenti Hajrizi citoi se angazhimi i madh i studentëve në UBT dhe argumentet e shumta të cilat i kanë paraqitë për nivelin e zhvillimit të UBT-së, mbështetur në programe studimore të anëtarësuar edhe në mekanizma ndërkombëtar UBT ka dal të thyej bllokada të shumta duke u shëndrruar në ambasador të vendit tonë, për prezantimin e vlerave të shumta ekzistuese dhe synimeve të

vendit tonë, për prezantimin e trendëve më bashkëkohore në shkencë dhe teknologji duke i bindur të gjithë të tjerët se në Kosovë ka vërtetë vlera që duhet çmuar dhe përkrahur se studentët kosovarë mundë të përfaqësohen denjësisht në të gjitha rrethet kulminante shkencore në Botë.

Poashtu vlen të theksohet se UBT është përfituese e rregullt dhe e para e projekteve të Komisionit Evropian si "Tempus", "SEECCEL- South East European Countries for Enterpreneurship Learning", përfituese projektit "Erasmus Mundus", që përmes këtij projekti studentët e UBT-së kanë të drejtë dhe të pajisën me bursa dhe të studiojnë në 16 universitete të vendeve të BE-së dhe të rajonit si: City University London, Freie University Berlin, Lappeenranta University of Technology, Wrocław University of Technology, University of Bucharest, Technical University of Cluj-Napoca, University of Business & Technology, Polytechnic University of Tirana, University of Sarajevo, University of Tuzla, University of Split, University "St. Kliment Ohridski", Bitola for University of Novi Sad. UBT veçantë ka marrëveshja me City University London dhe qw nga ky viti i ri akademik do të mundësoje studenteve kosovarë, studentëve të UBT-së që studimet universitare në nivelin bachelor, master dhe në doktoraturë ti ndjekin në UBT dhe në Universitetin City etj.

UBT organizoi për herë të dytë Kampionatin Evropian të Robotëve që luajnë futboll dhe UBT "Kosova-Robots", ekipi i përbërë nga studentë tanë rrëmbeu kupën e Evropës përfundoi Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.



INTERVISTË ME PROF. DR. FETAH JAGXHIUN, DEKAN I FAKULTETIT ARKITEKTURËS NË UNIVERSITETIN PËR BIZNES DHE TEKNOLOGJI UBT

NGA UBT-ja KANË DALË SHUMË EKSPERTË TË MIRË

Për një ekspert-arkitekt të suksesshëm nuk mjafton vetëm kryerja e studimeve të programit studimor Bachelor, por duhet edhe përvojë pune në praktikë dhe brenda mundësive edhe vazhdim i studimeve në programin studimor Master.

“UBT News: Në ç’mënyrë është punuar për sigurimin e cilësisë dhe akreditimin për Fakultetin e Arkitekturës?”

Jagxhiu: Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor me programin studimor Bachelor në UBT ka startuar në vitin akademik 2005/06, me mesim në gjuhën angleze me Stafin akademik, kryesisht ndërkombëtar (nga Austria). Kurrikulën e këtij programi studimor e kishte përgatitur stafi akademik ndërkombëtar.

Edhe gjenerata e tretë, 2007/08, ka vazhduar me programin studimor, por kësaj radhe të modifikuar me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë. Studimet u zhvilluan në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Po në këtë vit shkollor, për herë të parë në Kosovë në UBT, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, organizohen edhe studimet në programin studimor Master në Arkitekturë, Planifikim Hapësinor dhe Menaxhim të Projekteve, në gjuhën angleze, me stafin akademik ndërkombëtar.

Për përgatitjen e Kurrikulës për vitin akademik 2011/2012, pas përvojës shumëvjeçare universitare të shumicës së anëtarëve të Grupit punues patëm edhe në UBT përvojën katërvjeçare të studimeve me Kurrikulave të programeve studimore Bachelor dhe Master. Grupi punues ka studiuar edhe shumë Kurrikula të Universiteteve më prestigjioze të shteteve të UE-së. Po ashtu kemi analizuar edhe nevojat specifike të Kosovës nga kjo lëmi, dhe kemi përcjell rezultatet e studentëve të diplomuar në UBT. Kuptohet kemi marrë parasysh edhe sugjerimet e ekspertëve ndërkombëtarë që kanë qenë në komisionet për akreditim.

Tani mund të them se Kurrikulat aktuale të programit studimor Bachelor të Fakultetit të Arkitekturës u vlerësuan lartë nga ekspertët ndërkombëtarë (nga raporti i tyre), të cilat janë të krahasueshme me shumë programe studimore të këtij niveli të Universiteteve shumë prestigjioze siç janë: Universiteti Teknik i Vjenës, Universiteti Teknik i Berlinit, Universiteti Teknik i Delft-it në Holandë,

Universiteti i Zuchri-ut në Zvicër ndërsa nga Regjioni me Universitetin e Mariborit në Sloveni.

Në grupin punues për përgatitjen e Kurrikulës ishin katër profesor universitar vendor dhe dy profesorë universitarë ndërkombëtarë, dy doktorë shkencash vendas nga lëmi i arkitekturës, ndërsa Syllabusat janë hartuar nga stafi akademik për çdo lëndë nga ana e mesimdhënësit përkates.

“UBT News: Cili është interesi krahasuar me vitet e kaluar për të studiuar në këtë fakultet dhe sa jeni të kënaqur?”

Jagxhiu: Sa i përket interesimit për studime të Arkitekturës, ka ekzistuar gjithmonë jo vetëm në Kosovë që nga themelimi në Universitetin e Prishtinës, po ashtu edhe në Universitetet e tjera. Kjo dukuri vërehet edhe në UBT ku deri tani kemi rreth 200 studentë dhe shumë kërkesa, por fatkeqsisht nuk do të plotësohen dëshirat e të gjithëve. Kemi pas shumë të interesuar edhe për studime paralele me punën, por edhe këto kërkesa nuk ishim në gjendje t'i plotësojmë, sepse mendojmë se këto studime janë më specifike dhe kërkojnë angazhim të plotë të kandidatëve. Nëse bëhet krahasim me vitet paraprake interesi është shumëfishuar këtë vit. Kuptohet me interesimin e kandidatëve jemi të kënaqur, dhe kjo ka ardhur si rezultat i sukseseve të studentëve nga gjeneratat paraprake-punësimi apo studimet Master.

Kurrikulat tona janë kompatible me ato të shteteve të UE-së. Kosova si dhe të gjitha shtetet e rajonit kanë ambicie të jenë pjesë e UE-së, prandaj gjatë hartimit të Kurrikulës kemi pas parasysh edhe këtë fakt.

“UBT News: Fakulteti i Arkitekturës është më specifik krahasuar me tjera departamente. Cilat janë përparësitë dhe vështirësitë ta menaxhoni një departament të tillë?”

Jagxhiu: Ky fakultet është jo pak, por shumë më specifik në krahasim me departamentet e tjera. Kemi përparësi se në këtë departament janë regjistruar kryesisht studentë të shkëlqyeshëm, shumë të mirë etj. Kjo strukturë premton edhe sukses të mirë. Këto studime janë specifike, sepse këtyre studentëve nuk mjaftojnë vetëm karriget dhe bankat, por tavolina pune e tabela pune si dhe mjete të teknologjisë kompjuterike. Duhet grupe

të vogla për ushtrime nga lëndët specifike si dhe punë individuale me çdo student.

“UBT News: Me kërkesat e tregut, sa iu përgjigjeni ju atyre si institucion akademik?”

Jagxhiu: Edhe më lartë u cek se me rastin e përgatitjes së Kurrikulës kemi marrë parasysh edhe nevojat dhe specifikat e tregut Kosovar nga kjo lëmi. Por jo vetëm tregut Kosovar, por edhe asaj të UE-së nga se Kurrikulat tona janë kompatible me ato të shteteve të UE-së. Kosova si dhe të gjitha shtetet e rajonit kanë ambicie të jenë pjesë e UE-së, prandaj gjatë hartimit të Kurrikulës kemi pas parasysh edhe këtë fakt. Gjatë punës me studentë gjithmonë do të kemi synimin që të diplomuarit në UBT të jenë konkurrentë edhe në tregun e madh të UE-së. Ne i përmbahemi asaj filozofie se më mirë është që Kosova, nëse ka nevojë të eksportoje ekspertë (dijen) sesa punëtorë krahu, ky është edhe vizioni ynë.

“UBT News: A mendoni që brenda një kohe të shkurtë nga UBT do të dalin arkitektë të shkëlqyeshëm?”

Jagxhiu: Studimet e programit studimor Bachelor zgjasin tre vite (gjashtë semestra). Ata më të mirët, me punë serioze, ne shpresojmë dhe besojmë se do ta kryejnë brenda këtij afati. Mirëpo, duhet të jemi të vetëdijshëm se këto studime janë shumë serioze me punime të shumta të elaborateve (projekteve) dhe se edhe në fakultet me traditë të gjatë, mesatarja e kohëzgjatjes së studimeve është mbi katër vite. Për një ekspert-arkitekt të suksesshëm nuk mjafton vetëm kryerja e studimeve të programit studimor Bachelor, por duhet edhe përvojë pune në praktikë dhe brenda mundësive edhe vazhdim i studimeve në programin studimor Master. Siç e kam cekur edhe në fillim, nga UBT kane dalë shumë ekspert të mirë-arkitekt, nga katër gjeneratat paraprake.

Studentë të diplomuar në UBT mund të vijojnë studimet kudo në UE dhe në SHBA

“UBT News: Profesor, ju tani përmendët programin studimor Master për aftësimin të mëtejshëm të studentëve që kryejnë programin studimor Bachelor. A keni menduar edhe për këtë çështje -vazhdim të studimeve?”

Jagxhiu: Po gjithsesi. UBT-ja ka lidhur marrëveshje me shumë Universitete partnere, që pa kurrfarë problemi studentët e diplo-



muar në programin studimor Bachelor mund të regjistrohen dhe të vazhdojnë studimet në programin studimor Master dhe po e cekim disa: Universiteti City në Londër, Universiteti Teknik i Vjenës, Universiteti i Dublin-it në Irlandë etj.

Mirëpo, nuk janë vetë këto mundësi, edhe gjatë përgatitjes së Kurrikulës për programin studimor Bachelor kemi përgatitur edhe Kurrikulën e programit studimor Master, mirëpo ishte një marrëveshje me Agjencinë për Akreditim të Kosovës që këtë vit të startojmë vetëm me programin

studimor Bachelor, ndërsa vitin e ardhshëm kemi vullnet dhe ambicie që të aplikojmë edhe këtë program studimor, në mënyrë që këto studime ti vijojnë studentët e Kosovës edhe në Prishtinë. Edhe këtu kemi përvojë nga se ishim të parët në Kosovë që startuam edhe me këtë program dhe shpresoj që do të vazhdojmë.

Ne studentët tonë do t'i edukojmë që mos të jenë pjesë e kësaj të keqeje dhe të respektojnë ligjin, kodin dhe etikën e profesionit

“UBT News: A do të mundeni ju dhe studentët tuaj të UBT-së të kontribuoni në përmirësimin e kësaj gjendjeje kaosi që po mbretëron në disa zona urbane të Kosovës?”

Jagxhiu: Ne si Staf akademik, me Kurrikulën tonë tentojmë që studentët tonë të përgatisim si ekspertë të mirë të nivelit Bachelor. Po ky nuk është misioni i vetëm, ne do të përpiqemi që të edukojmë studentët tonë të respektojnë kodin e profesio-

nit, dmth. të punojnë drejtë, me ndershmëri dhe sipas etikës profesionale, të respektojnë ligjet e shtetit dhe planet rregulluese. Fatkeqësisht kaosi nuk mbretëron vetëm në disa zona urbane të Kosovës, por më së shumti në kryeqytetin e Kosovës. Kjo dukuri - kaosi është ngushtë i lidhur me të keqë e madhe që ka emrin korrupsion. Ky kaosi është shumë kompleks dhe ka shumë pjesëmarrës, duke u nisur nga politika. Fatkeqësisht edhe ekspertët aktual në lëmin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës janë pjesë e këtij krimi, sepse edhe një pjesë e tyre marrin pjesë në projektimin, ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e objekteve ilegale që ngriten si kërpudhat pas shiut. Ne studentët tonë do t'i edukojmë që mos të jenë pjesë e kësaj të keqeje dhe të respektojnë ligjin, kodin dhe etikën e profesionit. Në këtë mënyrë ata do të kontribuojnë në evitimin e kësaj keqeje-kaosi që do të lërë gjurma të zeza në civilizimin tonë.

“UBT News: Profesor, këtu bashkë me Arkitekturën përmendët edhe Ndërtimtarinë si dy drejtime që gërshetohen. A keni menduar që të aplikoni për akreditim edhe programin studimor Ndërtimtari, meqë keni dhënë mësim në të dy departamentet në FNA të UP-së.

Jagxhiu: Jo vetëm që kemi menduar për këtë çështje por edhe kemi vepruar, duke formuar grupin punues prej profesorëve më eminentë të kësaj lëmie të cilët edhe kanë hartuar edhe Kurrikulat për programet studimore Bachelor dhe Master për “Ndërtimtarinë me infrastrukturë” të cilat janë të kompletuara, dhe janë në procedurë të akreditimit. Kurrikulat janë përgatitur ashtu që tentojnë të plotësojnë nevojën e madhe që ka Kosova dhe për profilin që i mungon. Në Kosovë ndërtohen Autostrada e nuk janë ekspertët nga kjo lëmi. Në UP në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës që nga themelimi nuk janë organizuar studimet e ndërtimtarisë për infrastrukturë - për rrugët dhe hekurudhat. Kjo do të ishte edhe një kontribut Kosovës nga ana e UBT-së. Shpresojmë dhe besojmë që do të kemi edhe përkrahjen e AAK-së, që kjo edhe të realizohet së shpejti!

“UBT News: Cilat janë përparësitë e UBT karshi Universitetit publik?

Jagxhiu: Meqë isha ndër themeluesit e parë të Fakulteti Teknik në UP si dhe të Departamentit të Arkitekturës në atë Fakultet, dhe e di Kurikulën e atij departamenti, me rastin e hartimit të Kurrikulës së Fakultetit të Arkitekturës në UBT kemi pas parasysh si anët pozitive dhe mangësitë e Kurrikulës së atij departamenti të FNA, dhe jemi përpjekur që t'i evitojmë ato mangësi në Kurrikulën tonë. Kemi futur disa lëndë të rëndësishme, pos tjerash edhe lëndën obligative “Puna praktike në terren”.

Ky modul përfshinë angazhimin e studentëve në kompanitë e ndryshme projektuese ndërtimore, për të realizuar punën praktike në fondin e orëve

të parapara në lëmin e organizimit dhe menaxhimit, dizajnimin dhe inxhinieringut për projekte të caktuara. Pra është ndërlidhje mes mësimin teorik të studentit dhe praktikë të tij në punishte.

“UBT News: UBT tash mbush 10 vjet punë, si do ta shënonit këtë ditë madhështore për UBT- në një përgjithësi si për studentin, stafin menaxherial, akademik, etj

Jagxhiu: Jam në dijeni se UBT për këtë jubile është duke përgatitur edhe një Monografi, për të cilën kam dhënë edhe një deklaratë. Kemi arsye të festojmë ngase janë arritur rezultate të konsiderueshme. Studimet i kanë përfunduar shumë studentë, janë punësuar dhe me sukses janë duke krijuar karrierën e tyre. Për në stafin akademik ky është një satisfaksion ngase suksesi i tyre është edhe suksesi ynë. Natyrisht ne nuk duhet të kënaqemi me të arriturat, por puna jonë sikurse edhe e studentëve duhet të jetë sistematike gjithmonë duke rinovuar, modernizuar Kurikulën dhe cilësinë e tyre. Me rastin e pranimit të kësaj gjenerate në fjalën përshëndetëse pata thënë dhe tani po përsëris se qëllimi dhe ambiciet e Stafit akademik të UBT-së nuk është vetëm që studentët të fitojnë diploma por dije që do të shërbej për një karrierë të suksesshme dhe të dobishme për shoqërinë kosovare. Ky festim le të jetë edhe një stimulim për arritje të sukseseve edhe më të mëdha.

“UBT News: Dhe së fundi, çfarë do t'i porosnit ju studentët tuaj, por edhe institucionet përgjegjëse lidhur me arkitekturën që sot po zhvillohet në Kosovë, është e qëlluar apo duhet ndryshuar?

Jagxhiu: Po tani mesazhi im për studentët e Arkitekturës që posa filluan studimet është: punë dhe vetëm punë sistematike, edhe për ata që nuk kanë qenë nxënës të shkëlqyeshëm, mund të arrijnë sukses dhe të bëhen arkitekt të suksesshëm vetëm me punë serioze, pa pas paragjykim “se për studimet e Arkitekturës duhet pas prirje të lindur”. Prirja mund të jetë disa për qind po puna e është 95% e suksesit. Edhe pasi të kryejnë këto studime prapë punë në përsosje ose vazhdim i studimeve në programin studimor Master. Të përsëris punë profesionale, dashuri në profesionin që vetë e kanë zgjedhur, respektim të ligjeve të shtetit, planeve rregulluese, veçmas respektimit të kodit dhe etikës së profesionit -ndershmërinë në profesion dhe kudo! Sa i përket përgjegjësisë së institucioneve, ato kanë mjaftë punë të kryejnë në lëmin Arkitekturës dhe Ndërtimtarisë: shumë ligje, standarde nacionale mungojnë, mungon edhe planet rregullative jo vetëm për vendbanime të vogla, po as kryeqyteti nuk e ka planin rregullativ të kompletuar, por këto nuk mjaftojnë, duhet ato edhe të respektohen, mbikëqyrjen nga organet e shtetit. Këto janë ato që biseduam për kaosin, kaosi në legjislaturë, mungon edhe sanksionimi për mos respektim të ligjeve dhe planeve rregulluese. Duhet bërë shumë ndryshime jo vetëm në letra por edhe në kokat e të gjithë pjesëmarrësve në këtë lëmi.

Intervistoi: N. Demiri

U NËNSHKRUA MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT MES UBT-së DHE UNIVERSITETIT GJEORGHE CRISTEA

PRISHTINË, 25 SHTATOR 2011 - Me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit universitar dhe atë akademik dhe në pajtim me qëllimet dhe interesat e përbashkëta, Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Gjeorghe Cristea në Bukuresht të Rumanisë.

Kjo marrëveshje e dëshmon qëllimin e të dy institucioneve që të fillojnë dhe zhvillojnë bashkëpunim të ndërsjellë në procesin e edukimit dhe punën kërkimore-shkencore.

Po ashtu marrëveshja parasheh se dy universitetet do të marrin pjesë në programet arsimore dhe shkencore, do të angazhohen të realizojnë projekte kërkimore-shkencore me interes të përbashkët, konferenca shkencore, simpoziume, seminare, punëtori shkencore dhe profesionale.

Po ashtu, do të shkëmbejnë libra, revista, publikime, botime bibliografike, literaturë shkencore dhe metoda shkencore me interes të përbashkët, si dhe të shkëmbejnë plane dhe programe mësimore për të gjitha ciklet e studimeve universitare.



FILLON BASHKËPUNIMI ME LINNÆUS UNIVERSITY



PRISHTINË, 14 KORRIK 2011 - Në kuadër të marrëveshjeve të shumta që i ka Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), me universitetet e tjera më prestigjioze në Evropë dhe botë, Presidenti i UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, dhe Prorektori për Çështje Shkencore pranë Universitetit Linnæus, Prof. Gösta Sunberg, zhvilluan një takim të përbashkët dhe nënshkruan një marrëveshje bashkëpunim ndëruniversitar.

“Marrëveshja parasheh mundësimin e shkëmbimit të stafit akademik dhe të studentëve, që studentët të organizojmë seminare dhe takime tjera akademike për çështje shkencore, përdorimin e bibliotekave përkatëse për nevojat e studimeve dhe hulumtimeve shkencore, programe të studimit në distancë, zbatimin e përbashkët të programeve postdiplomike, aktivitetet lidhur me kurset verore dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet”,

theksoi Presidenti i UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, pas nënshkrimit të marrëveshjes.

Sipas palëve nënshkruese, bashkëpunimi ndëruniversitar ndërmjet UBT dhe Linnæus University ka filluar edhe më herët.

Në bazë të bisedave që patën mes udhëheqësive e institucioneve në fjalë, Presidenti i UBT-së Dr. Hajrizi u nda i kënaqur me të arritura e Linnæus University, sidomos me programet e studimit në teknologjinë më moderne, me stafin akademik dhe me arritjet e studentëve.

Linnæus University numëron një numër të konsiderueshëm të mësimdhënësve dhe ka marrëveshje të shumta bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare, numri i të diplomuarve është i krahasueshëm me universitete më të mëdha në botë, po ashtu të diplomuarit sot janë në vende udhëheqëse nëpër kompani dhe organizata më profitabile në Evropë dhe botë.

STUDENTËT E UBT-së FITUAN BURSA STUDIUMI NË 16 UNIVERSITETE TË VENDEVE TË BE-së

NGA UBT NË VENDEVE TË BE-së

PRISHTINË, 9 KORRIK 2011- UBT prej themelimit në vazhdimësi është përfituese e projekteve ndërkombëtare të sektorit të arsimit në Evropë dhe më gjerë. Përveç tjerave, këtë vit dhe për katër vitet e ardhshme UBT është përfituese e projektit "Erasmus Mundus", projekt i Bashkimit Evropian, dhe nga ky projekt, po në këtë vit, shumë studentë të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), kanë fituar bursa të plota studimi për vitin e ri akademik 2011-2012, në të gjitha nivelet e studimit si bachelor, master dhe të doktoratës, të cilët do të fillojnë mobilitetin e tyre në universitetet më prestigjioze të vendeve të Bashkimit Evropian, u tha gjatë një konference për media, të organizuar në ambientet e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), në Prishtinë.

Studentet të cilët janë pranuar dhe kanë fituar bursë të plota për studime në kuadër të projektit në janë:

Në Universitetin Limerik në Irlandën janë pranuar këta studentë si Njomza Havolli, Blertë Bytyci, Egzon Dushku, Anesa Ramaxhiu, Burim Ramadani, Rineta Jashtari, Arnisa Kryeziu, Agron Krasniqi, kurse në Universitetin City në Londër në Britani të Madhe janë pranuar këta student si Drilon Zenuni, Rina Sadriu, Ndriqim Idrizi, Diana Llugaxhiu, Fatlum Gerguri, Haris Haxhimehmeti, Shkurte Berisha dhe Arian Again, kurse në Universitetin Freie të Berlinit është pranuar Qendresa Sopjani, Erođita Llugaxhiu, Mirsad Kosumi në Universitetin e Bukureshtit në Rumani dhe Lirigzona Morina në Universitetin Lapenarta në Finland. Po ashtu përmes këtij projekti kemi kandidatë për studime



të pos-doktoratës si Binak Beqaj, në Universitetin "City" në Londër etj.

Pasi UBT është përfituese e projektit "Erasmus Mundus", dhe në kuadër të këtij përfshihen 16 universitete nga rajoni dhe Evropa, prej tyre tetë nga vendet e Ballkanit, ndryshe UBT është Universiteti i vetëm privat nga Kosova dhe rajoni që është përfituese e projektit në fjalë, i cili projekte është në vazhdimësi edhe për katër vitet e ardhshme për studentët e kosovarë.

"Përmes këtij projekti përveç që ofron bursa të plota studimi për studentët tanë në të gjitha nivelet e studimit, në universitete më prestigjioze të vendeve të Bashkimit Evropian, po edhe studentët e universiteteve që përfshihen brenda projektit vijën të studiojnë në Kosovë" tha i pari i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi

Përveç bursave të studimit projekti "Erasmus Mundus" përfshinë edhe aktivitete tjera si trajnime në ndërmarrësi, menaxhment, shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë.

Projekti ka një shumë 3.8 milionë euro dhe të drejtë aplikimi do të kenë të gjithë studentët

kosovarë. Krahas tjerave UBT e ka edhe një privilegj përfshirë brenda projektit, sepse për katër vite me radhë është koordinatore e këtij projekti, citoi ai.

Ta përkujtojmë edhe një fakt se, se UBT ka një varg marrëveshje me universitete më prestigjioze në Evropë dhe botë, si me "CIFE" në Francë, për studime në Integritet dhe të Drejtën Evropian, profesorët nga universitete e vendeve të me njohura vijën në Kosovë, pikërisht në UBT dhe ligjërojnë, dhe në fund studentët marrin diplomë, sikurse gjenerata e kaluar nga institucioni në fjalë. Një bashkëpunim i tillë është edhe me Danube University Krens nga Austria, programi ka filluar që një vit të zhvillohet, tash në vitin e ri akademik nis semestri i tretë, po ashtu në UBT, dhe për studentet që janë bërë pjesë e këtyre institucioneve u është ofruar bursa studimi etj.

Po ashtu studentët përmes UBT-së edhe e kanë pasur mundësin depërtimit në universitete të cekura më lartë. Si shembull po i citojmë vetëm disa kandidatë, të cilët kanë përfunduar një pjesë të studimeve në UBT dhe për më tutje kanë vazhduar në universitete të Evropës dhe UBT-ja është e vetmja prej institucioneve të arsimit të lartë privatë që studentëve të vet ju krijon këtë mundësi të studimit të doktoratës jashtë vendit.


Për shembull, Dr. Binak Beqaj ka përfunduar studimet themelore në UBT, dhe më pas brenda muajit prill 2011, ka përfunduar studime e doktoratës në Universitetin Teknik (TU) të Vjenës në Austri dhe u shpall dr. nga fusha e planifikimit dhe menaxhimit urban, kurse Mimoza Du-

golli, Lulzim Beqiri dhe Muhamet Ahmeti, kanë përfunduar studimet master në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), dhe gjatë këtyre ditëve kanë marrë confirmimin nga TU-ja.

Leana Mahmuti e cila para tre viteve ka përfunduar studimet themelore në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Fakulteti Arkitekturë, kurse Masterin në Universitetin "Politecnico Di Milano" në Itali, drejtimi Arkitekturë. Ermal Lubishtani, i ka përfunduar studimet Master në Mbreterinë e Bashkuar (UK), në Staffordshire University në Business School, Ilir Hajdini, në "University of Sussex" po ashtu në Angli. Vigan Sadiku, studimet posdiplomike ka përfunduar në Suedi në Lund University, në Fakultetin Lund School of Economics, etj.

Po ashtu për tu bërë pjesë e studimeve në vendet e BE-së, këtë mundësi në vende ofron vetëm UBT përmes projektit "Erasmus Mundus", po ashtu UBT ofron mundësin të studimeve edhe përmes projekteve të ndryshme që ka në proces edhe përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Universitete që përfshihen brenda projekti në "Erasmus Mundus" janë: City University London, Freie University Berlin, Lappeenranta University of Technology, University of Bucharest, Technical University of Cluj-Napoca, University of Business & Technology, Polytechnic University of Tirana, University of Sarajevo, University of Tuzla, University of Split, University "St. Kliment Ohridski" Bitola for University of Novi Sad, etj.



UBT BASHKËPUNON ME SHUMË UNIVERSITETE DHE KOMPANI TË REPUBLIKËS SË ÇEKISË

UBT bashkëpunon me Universitetin e Pardubice

PRISHTINË, 11 TETOR 2011- Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji- UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, gjatë qëndrimit të tij në Pragë të Republikës së Çekisë zhvilloi një varg takimesh me rëndësi, ku njëkohësisht u takua me krerët më të lartë të Universiteteve të vendit në fjalë. Prof. Dr. Hajrizi u takua me prorektorin e Universitetit Pradubice, Prof. Dr. Karel Rydl.

Dy krerët e dy institucioneve biseduan për të gjitha mundësitë e bashkëpunimit në një të ardhme të afërt në të gjithë nivelet e studimit si master dhe atë të doktoratës dhe për projektet e përbashkëta në atë evropian dhe rajonal, shkëmbimin e literaturës më të avancuar dhe për çështje tjera akademike të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet. Përveç takimi të ngrohtë miqësore vizituan edhe Qendrën Teknologjike të qytetit të Pardubicës.



UBT bashkëpunon me Universitetin e Pillzenit

Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, zhvilloi edhe një takim shumë të rëndësishëm në Universitetin e Pillzenit dhe u takua me prodekanin Prof. Dr. Vladimír Dushek.

Z. Dushek përveç të tjerave ka prezantuar përvojat dhjetëvjeçare të ndërtimit të një zone ekonomike dhe për rolin e universitetit në këtë zonë më konkretisht për ndërtimin e projektit në fjalë. Hajrizi dhe Dushek biseduan për mundësitë e bashkëpunimit ndëruniversitar.

UBT bashkëpunon me Universitetin Masarykova

Me këtë rast vlen të theksojmë edhe takimin e z. Hajrizi me rektorin e Universitetit Masarykova me Prof. Dr. Mikulash Bek, në qytetin Brno të Çekisë. Përpos mikpritjes së përzemërt, z. Bek shprehi gatishmëri për bashkëpunim ndëruniversitar në të gjitha nivelet e studimit e sidomos në fushën e doktoratës dhe shkëmbimin e studentëve. Po ashtu, të dyja palët vizituan kampusin e ri universitar të Universitetit Masarykova dhe parqet

industriale, që janë në kuadër të Universitetit. Ky bashkëpunim ndëruniversitar ndërmjet UBT-së dhe Universitetit Masarykova do të arrihet brenda një kohe të shkurtër, u tha pas takimit të krerëve në fjalë.

UBT bashkëpunon me Universitetin Teknik të Çekisë

Gjithashtu, Presidenti i UBT-së u takua edhe me prorektorin e Universitetit Teknik, Prof. Ing. Jiri Bila, Dr Sc. Ata biseduan që për të gjitha mundësitë e bashkëpunimit ndëruniversitar. Bila u nda i kënaqur me studimet që

ofron UBT-ja dhe konfirmoi se një bashkëpunim ndëruniversitar së shpejti pritet të fillojë brenda një periudhe të shkurtër.

"Toshiba" bashkëpunon me UBT-në

Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, gjatë vizitës së tij në Republikën e Çekisë ka vizituar edhe përfaqësinë e kompanisë së njohur në nivel botëror për teknologji "Toshiba", dhe takoi menaxherin kryesor të kompanisë në fjalë z. Juroslav Liskovec. Më konkretisht, gjatë takimit palët biseduan për

mundësin e bashkëpunimit mes dyja institucioneve e sidomos për sektorin e teknologjisë për me sjell robota industrial dhe laboratorë në Kosovë, pikërisht në UBT, në Fakultetin e Mekanikës, fakultet i vetëm në vend dhe rajon, ku studentëve u mundësohet të organizojnë praktiken shkencore etj.

Hajrizi u takua Mejstrik

Një takim shumë të rëndësishëm z. Hajrizi e zhvilloi edhe me kryetarin e Odës Ekonomike Ndërkombëtare të Republikës së Çekisë, me Prof. Michal Mejstrik. Më konkretisht të dyja palët biseduan për intensifikimin e marrëdhënieve të Republikës Çeke dhe Kosovës, dhe mundësitë e investimeve të kompanive Çeke në Kosovë. "Kryetarin e kam informuar për aktualitetin ekonomik e sidomos për investitorët e huaja në Kosovë, po ashtu e falënderova për përkrahjen e Qeverisë Çeke ndaj Republikës së Kosovës", tha z. Hajrizi. Dhe, në bazë të bisedave që patën z. Hajrizi u nda i kënaqur me takimin miqësor dhe nga ky takim pret rezultate të kënaqshme në nivelin e investimeve dhe në përkrahjen e mëtutjeshme të vendit.

Hajrizi u takua me Fara

Gjithashtu, z. Hajrizi u takua edhe me përfaqësuesit e Konfederatës së Industrisë të Republikës Çeke, Pavel Fara, i cili takim u zhvillua në kuadër të konferencës që është mbajtur në UBT, ku biseduan më gjerësisht rreth investimeve të huaja në Kosovë.

QUALITY KOSOVA U CERTIFIKUA NGA ORGANIZATA EVROPIANE PËR CILËSI

PRISHTINË, 20 QERSHOR 2011- Presidenti i UBT-së Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka qëndruar për disa ditë më radhë në Budapest të Republikës së Hungarisë, ku ka zhvilluar një varg takimesh të njëpasnjëshme të rëndësishme në nivel botëror, ku vlen të theksohet pjesëmarrja e tij në Asambleenë gjenerale 116 të Organizatës Evropiane për Cilësi (EOQ).

Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. E. Hajrizi në asambleenë në fjalë përveç pjesëmarrjes dhe që foli për zhvillimet e fundit në Kosovë në fushën e cilësisë dhe të standardeve, ai e përfaqësoj edhe organizatën Quality Kosova (QK), dhe, gjatë zhvillimeve të punimeve në asamble, QK përveç e që disa vite më radhë dmth prej themelimit të saj është dhe e pranuar me të drejta të plota si anëtare e rregullt, vlen të theksohet se edhe u certifikua nga EOQ, po ashtu baras me shtete pjesëmarrëse dhe anëtare në Organizatën Evropiane për Cilësi (EOQ).

Quality Kosova është themeluar dhe drejtohet nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) dhe e pranuar me të drejta të plota si anëtare e Organizatës Evropiane për Cilësi (European Organization for Quality). Quality Kosova funksionon që nga viti 2006 dhe është asociacion që merret me çështjen e kualitetit, standardeve, certifikimeve dhe konfirmimit. Promovon cilësinë në Kosovë, në bazë të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, merret me certifikimin e sistemeve e produkteve, si ISO 9001 e të tjerë.

Po ashtu sot dhe deri me 22 qershor 2011, organizohet Kongresi Botëror për Kualitet "55 EOQ Congress as World Quality Congress"- I pari i UBT-së do e prezantoj hulumtimin e tij: "Zhvillimin e sistemeve të avancuara për menaxhimin e cilësisë në ekonomitë emergjente". Në këtë kongres marrin pjesë ekspertë, shkencëtar dhe hulumtues nga mbarë bota.

Po ashtu më 22 qershor 2011, zhvillohet takimi i organizatës Aleanca Botërore



për Cilësi, dhe do marrin pjesë të krerët e të gjitha asociacioneve të shumicës së

shteteve kontinentale, kësaj ftese i është bërë edhe Presidenti i UBT-së, z. Hajrizi.

Me shkas

TË STUDIOSSH "PRANË UNIVERZITETIT"

Nuk është gjysma e shekullit të kaluar. Është viti 2011. Kosova është shtet. Ka Akademi të Shkencave, universitete, gjuhë të njësuar letrare, shumë kanale televizive, shumë gazeta, shumë doktorë shkencash, pak analfabetë, shumë tregtarë të zotë... Nisur nga kjo do të duhej besuar se, së paku në institucione, në media, në shpallje publike, në emërtime rrugësh, institucionesh, ndërmarrjesh... do të duhej të ekzistonin rregulla të qarta të të shkruarit. Por, kjo në Kosovë nuk është rregull. Mund të shkruash çka të duash, ku e kur të duash, dhe si të duash. Lëre që nuk të gjobit kush (shteti), por as nuk të përqeshin më. Sikur është bërë modë që të jesh i zoti nëse nuk e di dhe nuk e shkruan mirë gjuhën tënde! Rrugëtimi nëpër paragrafët dhe fotografitë e mëposhtme e dëshmon këtë.

Nisesh nga Çeveria e Kosovës, kalon nëpër periferi të Priştinës, i bie rrugës „Uesni Clark“, pi një “kampuchino” në lokalin të “Pishat” dhe shkon të vizitosh ndërtesën që ka në hyrje mbishkrimin “Komuna e Gjakovs”. Blen ca gjëra në lokalin “Gjithçka 3 euro” në Kodër të Trimave në Prishtinë, edhe diçka tjetër në lokalin “Gjithëçka 3 euro”, anashkalon lokalin “Gjithçka 3 euro”. Pastaj has tabelën e cila të bën me dije se “Ndalohut parkingu rrepcisht”, kalon nëpër Shakovic dhe mbërrin në Orllanë, ku pranë Liqenit të Batllavës pi një kafe në lokalin “Adriatik”.

Në bufenë në Kuvendin e Kosovës, ku zakonisht rrinë shumë deputetë, është një tabelë që tregon se aty mund të hyjë vetëm një deputet. Kështu thotë tabela: “E rezervuar vetëm për deputet”. Dhe kjo vlen vetëm për deputetët shqiptarë, sepse në serbisht (edhe në anglisht, edhe pse nuk kemi asnjë deputet anglez), teksti është i shkruar mirë. Por, deputetët, dhe gjithë të tjerët, mund të bëjnë një zgjidhje, pasi ka shumë lokale në Prishtinë që të qëndrojnë “Open” 24 orë. Të tjerat që, sikur edhe ato që punojnë pandërprerë, kanë emra e mbishkrime në shqip, pas orës 23h, vënë në derë një tabelë metali në të cilën shkruan “Closed”.

Në një lokal më të madh me emrin “Noti” organizohen ahengje të ndryshme. Në ftesën për aheng shkruan se “Rezervimi është i obliguar vetëm për qifte”. Nëse e shikojmë Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, i bie se rezervimi është i obliguar nëse shkon në qift, që është “shpend i madh grabitqar, me krahë të mëdhenj zakonisht të zinj, me kokë si në të bardhë, me sqep të kthyer e me bisht të bigëzuar, që ushqehet me kafshë të vogla e me zogj”. Pra, fjala është për skifter. Me gjasë, pronari ka menduar për çift të dashuruarish, të fejuarish, të martuarish. I ka dalë se në vend të njerëzve në ndejë ka ftuar zogj!

Një profesor universiteti, që merret edhe me një punë të dytë, e thërret dikush në telefon. “A i morre pyetjet e mia”, - e pyet. “I mora”, - ia kthen ai. “Por, e para, morra paq vet dhe, e dyta, nuk mora vesh gjë nga teksti yt. Shkruaje në shqip dhe ma dërgo edhe një herë”. Teksti është ky: “Pershendetje i nderuar, jam Po me duhet nje prononcim i juaji lidhur me: Pse nuk i eshte derzuar titulli “dekorata pre ari” familjareve te te dekuruarve Azem e Shote Galices tash e me shume se 18 muaj..? C’far eshte bere me kete dekorat, dhe ku ndodhet ajo e cila eshte prej ari qe mban stemen e Skenderbeut... ? nese keni informata shtes te lutem dergomi ne kete imail ose ne numrat e tel me posht... Shkrimi do te botohet (te marten), dhe ju lus qe te prononcoheni rreth kesaj qeshtje... mundesishite te henen para-dreke. Me respek,...”

Ky që thirri, kuptohet nga teksti, është gazetar. Ka qenë sigurisht duke dëgjuar këngën “Mbretnesha koh” apo “Sa mka marr malli”, albumin “I pavdekshëm”, “Vdekrisht të dashuroi”, “Ti e din ilaqin tem” apo “Shum her tu luta” kur e ka shkruar atë tekst. Nuk ka gjë. Ka edhe më. “Kjo është kaq e vërtetë saqë, është trajtuar edhe në mbledhjet e këshillit komunal të fshatit. Sipas numurit një të këtij fshati, Jean-Pierre Delort, ata...”, shkruan në një portal lajmesh. Një televizion u drejtohet shikuesve të vet kështu: “A-Mol ju Uronë fat, shëndet...”. Një agjenci tjetër shkruan: “Schvarzenegger e lëshon Californin me deficit”. Ndërsa një gazetë citon një sportist, i cili thotë “...do ta fitojmë këtë kompeticion”.

Kur ulesh për drekë në lokalin “Aga i Vet”, sigurisht që mishin e pulës që ta shërbejnë e kanë marrë nga ferma e pulave “Shqiponja”, ndërsa mishin tjetër nga mishtorja “Fruktus”. Specat që na i vë në tavolinë kamerieri janë të firmës “Vipro”, me këtë mbishkrim në tiketë: “Djégse... Specë i qkymë i pjekur... Tipi Kavardjik” (përkthyer fjalë për fjalë nga serbishtja). Lëngu i tipit “Fructal” mund të jetë blerë në një dyqan ku emërtimi i tij është “Frictal” dhe ku, po kërkove lëng të japin vetëm lëngje pemësh, për shkak se pijet e gazuara –freskuse janë sok dhe jo lëng!

Jo vetëm në qytetet më të vogla, por edhe në kryeqytetin tonë, që mban ende tabelën e turpshme “Priştina” në hyrje nga ana e Lipjanit, ka shumë probleme me emra rrugësh e me adresa. Njëra nga lagjet ku banorët, po edhe institucionet që e kanë selinë aty, kanë më së shumti telashe me adresat e tyre është lagja “Dardania”. Ndonëse lufta ka mbaruar tash më shumë se një deçenie, në shumicën e ndërtesave në këtë lagje vazhdon të jetë emërtimi “SU”, të cilit i shtohen në vijim numrat përkatës. Më të vjetrit e kuptojnë, për të rinjtë duhet shpjeguar se SU është shkurtesë për fjalën në serbisht “Stambeni Ulaz”, që në shqip i thonë “Hyrye” dhe shkurtesën mund ta bëjmë shumë thjesht “Hy”. Nuk do të dukej tragjike një gjë e tillë, sikur edhe një institucion mjaft aktiv, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të mos e kishte selinë në këtë lagje, pikërisht në këtë adresë (siç e shkruajnë atë në shkresat dhe njoftimet e tyre): Dardania, SU 6/5-7, Prishtinë.

Në një komunikim me kolegun tuaj në internet ose me mesazh në telefon, pos tekstit që shkruar zi e më zi, me lloj-lloj shkurtesash që nuk merren vesh, shpesh mund të gjesh në fund përsëritjen: “Ok flm sps” (Okay – Faleminderit – S’ka përse). Nuk e ke të qartë sa mund të fitosh në kohë ose në para (mesazhi më i shkurtër kushton më pak), por një të menduar i përciptë të shpie te rezultati se me këto tri shkurtesa edhe mund ta fyesh dikë. E para është një shkurtesë e gjuhës angleze, shkurtesë ndërkombëtare, e njohur nga të gjithë. Lehtësisht mund ta zëvendësojmë me Mirë, e dyta është shkurtesë e fjalës shqipe Faleminderit. Nuk ka gjë të keqe nëse e shkruajmë të plotë. E treta është shkurtesë që edhe mund ta lëndojë shumë kë në këtë vend. Pse të mos e shkruajmë të plotë “S’ka përse” e ta shkruajmë me shkurtesën “sps”, e cila të gjithë neve na aludon në partinë e njeriut që deshi të na shfaroste dhe të na largonte të gjithëve nga vendi ynë.

Të shpeshta janë edhe rastet kur lexojmë diçka në gazeta apo dëgjojmë e shikojmë në radio e nuk kuptojmë për çka është fjala. Herë-herë ka gabime të rënda edhe faktike e herë të tjera teksti stërhollohet aq shumë sa kalohet në banalitet. Një gazetë jona, duke njoftuar për arrestimin e

DHE TË PUNOSH "PRANË ÇEVERISË"!



dy të rinjve në afërsi të kufirit Kosovë-Serbi, citon burimet e policisë se dy të rinjtë kanë dalë në shëtitje dhe gabimisht e kanë kaluar kufirin, ku janë arrestuar nga policia serbe. Por, gazeta shkon më tej, duke cituar "burime jozyrtare". "Të rinjtë prishtinas në Përpellac kishin dalë për të shëtitur dhe në momentin kritik ata kanë humbur rrugën dhe janë gjendur në territorin serb, prej nga edhe janë arrestuar", thotë policia. "Sipas njoftimeve jozyrtare, ata kishin dalë për të bërë dashuri në fshatin malor të Përpellacit, fshat ky i boshatisur kaheerë nga banorët vendas", thotë gazeta! Një gazetë tjetër nxjerr një xhevahir, sipas të cilit njerëzit po banuakan në stalla. Në fakt, artikulli thotë se policia ka dalë në terren dhe "në një stallë të pabanuar ka gjetur një granatë dore të ndryshkur".

Po në gazeta dhe në mediat elektronike, mund të gjenden gabime të lloj-lloj natyrash. Nëse një folës i lajmeve të sportit bën gabime elementare, pasi sipas tij "Prishtina" është *i pari*, ndërsa "Gjilani" *e dyta*, gabimet e tjera mund të duken luks. "Liverpool dhe Manchester United gjatë fundjavës ndanë pikët..." Si i kanë ndarë? Me sëpatë, thikë... "Kryetari ia ndau kupën ekipit fitues", shkruan një tjetër artikull. I shkreti ekip. Sipas këtij teksti i bie që kryetari njëherë e ka ndarë (thyer) kupën e pastaj ua ka dhënë copa-copa. Po kështu, njëri nga lojtarët është dënuar me pesë ndeshje ndalesë loje, për shkak të disa problemeve që ka shkaktuar. Folësi në TV thotë se "ai e ka mbajtur dënimin" dhe është kthyer sërish në ekip. Vetëm se, nuk thotë si e ka mbajtur: në dorë, në xhep, në sirtar... Besojmë se fjala është për vuajtjen e dënimin. Një TV tjetër ka edhe këtë fjali në emisionin e lajmeve: "Opozita derdhet në bulevard". Si u derdh, nga erdhi, me ndonjë cisternë, kamion...!

Të jesh anëtar redaksie, sidomos në gazeta, mund të neveritesh duke lexuar dorëshkrimet e akademikëve, madje edhe studiuesve të gjuhësisë, që në fund të tekstit shkruajnë edhe këtë porosi: "Ky tekst ka nevojë për redaktim gjuhësor". Po të lexosh biografinë e ndonjë politikani, mund të gjesh formulimin e thënë me krenari se "ai rrjedh nga një familje shumë e varfër, por patriotike". Mund edhe të besojmë në këtë, por nuk mund të kuptojmë se si "ai ka studiuar pranë Fakultetit të " dhe tash punon "pranë Univerzitetit të Prishtinës". Në fund fare, është i paqartë statusi i tij familjar. Shkruan kështu: "Është i martuar me tre fëmijë dhe jeton në...". Besojmë fort se personazhi ynë ka studiuar "në fakultet", punon "në Universitet" dhe "është i martuar dhe ka tre fëmijë...".

Të kthehem edhe një herë te mbishkrimet dhe njoftimet e ndryshme të subjekteve afariste. "Me brush – pa shkum", është njoftimi i një auto-larjeje, "Akcion – maica për mashkujë", shkruan në një tjetër, "Parging vetëm për barnatore", shkruan në një vend tjetër, ku nuk kuptohet a duhet të parkohen barnoret apo veturat. Një qytetare publikon këtë njoftim: "Lëshoj 3 studente me qera", ndërsa një tjetër, në një shpallje botuar në gazetë, shet banesën "mbas Amullantes". Madje, krejt afër mund të jetë rruga "Mujo Ulqinku", ndërsa më tej një banesë lëshohet "Me qira te Zahir Pajaziti" dhe kjo banesë i ka "90 fadrat". Një tjetër shet diçka, por njoftimin e ka vënë mbrapshtë në dritare dhe mund të lexohet vetëm nga ata që janë brenda e jo nga ata që janë jashtë. Në Shkup, ndërkaq, ku mund të kuptohet se bëhen përpjekje për përdorimin sa më të pakët të gjuhës shqipe në institucionet publike, ka edhe një mbishkrim si ky: "Kapshti Zoologjic", ndërsa në Strugë, një njoftim për një shfaqje cirku është e shkruar kështu në gjuhën shqipe: "Prej 13 gusht. Cirkuszi mbaet në stadiumin e rakometit në afri të pušimoren e Izviniçkit në Strug. Cirkuszi ka kopshtin zolozhik elefant, kamil, zebri, zi, majmun the tjer ogrsira". Të provojmë ta përkthejmë: Prej datës 13 gusht. Cirku organizohet në fushën e hendbollit, në afërsi të pushimores së Izviniçkit(?) në Strugë.).

Le të provojmë të besojmë se fjala, në të gjitha rastet, është për pakujdesi. Por, si të besohet?!!

S. Zejnullahu
(Bazuar në punimet e studentëve)

NË UBT U ZHVILLUA GARA EVROPIANE E ROBOTËVE QË LUAJNË FUTBOLL "EUROBY 2011"

"UBT KOSOVA - ROBOTS" FITOI KUPËN E EVROPËS

PRISHTINË, 04 MAJ 2011 – Organizuar nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), është mbajtur në Prishtinë Gara Evropiane e Robotëve, që luajnë futboll "EUROBY 2011", garë e këtij niveli që organizohet jo vetëm në Kosovë, por edhe në gjithë rajonin e Evropës Juglindore.

Në garën e cila zgjati deri më 6 maj, morën pjesë ekipe nga shtete të ndryshme, me traditë në fushën e robotëve, ndërsa Republikën e Kosovës e përfaqësoi ekipi "UBT-Kosova-Robots", i cili ka marrë pjesë edhe në kampionatin e organizuar vitin 2008 në Zvicër e Austri dhe në vitin 2009 në UBT.

Në ceremoninë e hapjes kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, profesorë e ekspertë vendorë e ndërkombëtarë, përfaqësues të kompanive të ndryshme, përfaqësues të biznesit, studentë e mysafirë të tjerë.

"Është garë interesante që e ndërlidhë sportin dhe shkencën. Gara organizohet nga Organizata Ndërkombëtare për Robotikë - FIRA. Them garë shkencore sepse përveç futbollit me robotë, në prapaskenë lidhet me arrijtet e mëdha shkencore. Me këtë, Kosova po jep mesazhin Evropës dhe më gjerë, që edhe ne bëjmë organizime të karakterit ndërkombëtar, të arrijteve shkencore profesionale me teknologjinë e fundit që ka Kosova, në këtë rast dhe në sport", theksoi Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Në këtë rast, vijoi ai, duhet çmuar faktin se vetëm Kosova, pikërisht UBT-ja organizon ng-



jarje të tillë në gjithë rajonin e Evropës Juglindore, duke qenë e para në rajon, para të gjitha shteteve të tjera. "Ky është një mesazh se rinia e Kosovës do t'i bind të gjithë se është në rrjedhat e zhvillimeve të fundit të teknologjisë moderne në botë", tha ai.

Në vijim, me një fjalë rasti, hapjen e ka përshëndetur Prof. Dr. Piter Kopaçek nga Universiteti i Vjenës për Teknologji, që është njëkohësisht edhe nënkryetar i FIRA-s dhe udhëheqës i FIRA-s për Evropë.

Ministri i MASHT-it e hapi garën

"Jam i gëzuar që marr pjesë në këtë garë shkencore dhe sportive, një gërshtim i çuditshëm logjik dhe përmbajtjesor. Kjo garë ka kuptim të shumëfishtë, por dua të theksoj njërin nga këto kuptime, se kjo garë realizohet në vigjilje të 9 majit, ditës së Evropës dhe ne në këtë ngjarje po tregojmë se jemi në nivel të dëshiruar shkencor dhe pretendimet tona janë drejt Evropës me cilësi. Unë besoj se kjo është një dëshmi shumë e fuqishme. Për mua është privilegj që po mbahet nën patronatin e

MASHT-it, sepse insistimi i këtij mandati është që të rrisë cilësinë dhe kjo është në kuadër të kësaj. I uroj këtij institucioni të lartë dhe prestigjioz suksese, gjithsesi shkencës që zhvillohet në këtë institucion dhe kësaj gare suksese", tha Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prof. Dr. Ramë Buja, gjatë hapjes solemne të garës në fjalë.

Gara u organizua nën patronatin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Po ashtu, sponsor i garës është edhe kompania "Ipkofundacion".

Në tri ndeshje, fiton UBT Kosova - Robots

REZULTATET:

Pas hapjes, para të pranimëve u zhvillua një lojë më shumë si demonstrim mes ekipeve, ku "UBT Kosova - Robots" fitoi ndaj HTL Leonding 14:4, dhe demonstrimi i dytë "UBT Kosova - Robots" fitoi ndaj ekipit Austro, po ashtu nga Austria, 4: 1.

1. Ekipet u forcuar dhe i hynë garës njëmend, ku ekipi "UBT Kosova - Robots" e mundi ekipin "HTL Leonding" nga Austria 7:5.





2. Më pastaj, garës i hynë, e kemi fjalën për ekipet nga Austria, ku "Austro" e mundi ekipin "HTL Leonding" me 21: 0.

3. Në lojën e tretë u zhvillua edhe një lojë mes "UBT Kosova - Robots" dhe "Austros", ku "UBT Kosova - Robots" prapë korri fitore 6: 5.

4. "Austro" e mundi "UBT Kosova - Robots" 3: 7.

5. Po ashtu, edhe një lojë mes dy ekipeve nga Austria, ku "Austro" fitoi ndaj "HTL Leadingit" 7: 0.

6. Dhe, në fund, "UBT Kosova - Robots" korri rezultate të theksuara kundër "HTL Leadingit" 9: 3.

Gjatë këtij organizimi tre ditë, u organizua edhe një konferencë shkencore, seminare dhe ligjëratat të nivelit të lartë nga fusha e mekatronikës dhe robotikës.

"UBT Kosova - Robots" fitoi edhe dy ndeshje

Gara Evropiane e Robotëve që luajnë futboll "EUROBY 2011", sot sollë edhe dy ndeshje, dhe në të dyja takimet ekipi "UBT Kosova - Robots", që po e përfaqëson Kosovën, korri fitore ndaj ekipeve mysafire nga Austria.

Në ndeshjen e parë luajtën ekipi "UBT Kosova - Robots" dhe ekipi nga Austria "HTL Leonding", ku ekipi "UBT Kosova - Robots" e mposhti bindshëm ekipin "HTL Leonding" 15: 2. Po ashtu, "UBT

Kosova Robots" e mundi edhe ekipin e radhës "Austro", 3:2.

"UBT Kosova - Robots" rrëmbeu kupën e Evropës

Më 6 maj u zhvillua ndeshja e fundit - finalja. Në finale u ndeshën dy ekipe si: "UBT Kosova - Robots", që e përfaqësoi Kosovën dhe ekipi "Austro", përfaqësues për Austrinë.

Ndaj "UBT Kosova - Robots", në finale e mposhti ekipin mysafir "Austro" me rezultat 3: 2, dhe ekipi kosovar u shpall kampion i Evropës në Futbollin për Robotë. Kjo ndeshje është zhvilluar në të ashtuquajturën ligë e madhe ose "EX tendet middle".

Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi është shprehur i kënaqur me mbarëvajtjen e këtij evropiani si dhe me suksesin e ekipit kosovar.

Po ashtu, Kushtim Dragusha - Kapiteni i ekipit kosovar, tha se arritja më e madhe është fitorja e ekipit ndaj "Austro", ekipi i cili është në treshen e më të mirëve në botë.

Në garë morën pjesë ekipe nga shtete të ndryshme, me traditë në fushën e robotëve, ndërsa Republikën e Kosovës e përfaqësoi ekipi "UBT-Kosova - Robots".

Gara u organizua nën patronatin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Po ashtu, sponsor i garës ishte edhe kompania "Ipkofundacion".

Të përkujtojmë edhe njëherë se gara në fjalë është organizuar dhe u zhvillua në Universitetin për Biznes dhe Teknologji UBT, Prishtinë.

STUDENTËT E ZHVILLOJNË INFRASTRUKTURËN E RRJETIT NË UBT



PRISHTINË, 13 TETOR 2011 - Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në bashkëpunim me Prof. Petrit Shalën kanë zhvilluar projektin për zhvillimin e infrastrukturës së re, më konkretisht të rrjetit në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Me anë të kësaj rrjete janë lidhur sistemi i kabllimit të ndërlihdjes të gjithë kompjuterëve në objektin e UBT-së dhe në detabazën elektronike akademike Moodle, po ashtu është krijuar edhe një databazë interneti për studentët e stafin e UBT-së ku me këtë bëhet menaxhimi i lëndës, orareve, notave dhe obligimet financiare.

Presidenti UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, tha se ky projekt tregon ndërlidhjen dhe bashkëpunimin e ngushtë të teorisë me praktikën, të profesorëve dhe studentëve.

Kurse Prof. Petrit Shala tha se projekti është planifikuar, dizajnuar dhe implementuar nga studentët e UBT-së dhe u shpreh i kënaqur me angazhimin dhe punën e tyre. "Studentët kanë treguar një shembull të një ekipi të përgatitur të nivelit të lartë profesionalisht dhe të gatshëm të garojnë edhe për projekte tjera ndërkombëtare jashtë UBT-së", tha ai.

Nga ana tjetër, Besim Shala, student i Shkencave Kompjuterike, i cili ka marr pjesë gjatë zhvillimit të projektit, shprehet i kënaqur për angazhimin dhe dijen e fituar gjatë zhvillimit të projektit në fjalë. "Me pas mundësi çdo gjë që thuhet në teori me zbatuar në praktikë, në veçanti drejtimi jonë kërkon praktikë të vazhdueshme dhe kërkon të preken sendet... jo vetëm të ulemi në klasë edhe t'i diskutojmë pa e ditur se për çka po flasim konkretisht". Kurse, Durim Jusaj shprehet i kënaqur me afërsinë dhe shpjegimin gjatë projektit që ka pas student - profesor. "Profesori Petrit Shala ka qenë me ne tërë kohën edhe përveçqë ishim duke punuar profesori na tregonte rëndësinë e çdo pajisje të rrjetës apo shpërndarjen e kabllave në mënyrë të rregullt, besoj se do të jemi në kontakt me profesorin z. Shalën edhe më tutje", ka thënë ai. Po ashtu, përveç Besimit dhe Durimit të cilët kanë marrë pjesë gjatë zhvillimit të projektit janë edhe Fatos Xhemajli, Fatjon Ahala, Selami Bibishi.

Ky sistem hyri në funksion me fillimin e viti të ri akademik 2011-2012.

REVISTA SHKENCORE E UBT E VETMJA ME NUMËR TË ISSN

Prishtinë, 18 gusht 2011 - Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), gjatë këtyre ditëve me të drejta e plota dhe i vetmi në Kosovë, si nga institucionet publike po ashtu edhe private, ka fituar Numrin Serik Ndërkombëtar të Librit (ISSN).

"Prej themelimit të universitetit kemi dhënë kontribut të vazhdueshëm në fushën e kërkimeve shkencore dhe njëkohësisht kemi botuar një numër të konsiderueshëm të revistave në disiplina të ndryshme, e sidomos nga fusha e ekonomisë. Kërkimet shkencore i kemi botuar në revista të universiteteve partnere ndërkombëtare. Tash tutje kërkimet do t'i orientojmë në revistën që e kemi brenda Universitetit", tha Prof. Dr. Edmond Hajrizi, President i UBT-së, pas pranimit të konfirmimit.

Numrin Serik Ndërkombëtar i Librit, ISSN-së, që renditet për UBT është - Bib ID (66488).

Organizata e ISSN-së qendren e saj e ka në Paris të Francës.





Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informativ
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathësi negocimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

Shkathësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënive me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktit
- Aqvi Comunnitëre e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatie
- State Protocol

Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

Teknologji Informativ

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënive me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vistër të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.

Kredi për studentë



**Raiffeisen
BANK**

...JETO MË MIRË

Financoni studimet tuaja

- Norma të volitshme interesi
 - 10,000 Euro deri në 5 vjet
 - 0% - shpenzime administrative

www.raiffeisen-kosovo.com
Raiffeisen Direct: 038 222 222

NGA UBT-ja STUDIME NË UNIVERSITETET MË PRESTIGJIOZE NË EVROPË DHE BOTË

N. Demiri

Studentët, të cilët shprehin dëshirë të bëhen pjesë e UBT-së në të gjitha nivelet e studimeve, mund të bëhen edhe pjesë e studimeve jashtë vendit, në universitetet më prestigjioze në Evropë dhe Botë.

Akomodimi për të depërtuar nga UBT-ja në universitete të tilla nuk ka qenë edhe i lehtë, por kjo është arritur në sajë të rezultateve të punës së palodhshme të menaxhmentit të lartë të UBT-së, duke siguruar bashkëpunime dhe marrëveshje të shumta me universitete, kompani dhe institucione me repute ndërkombëtare, si dhe duke ofruar bursa e njohuri të avancuara. Kjo ka mundësuar t'u ofrojë studentëve të vet programe të njëjta si në studime themelore, master etj.

Ja si shprehet prof. dr. Mohamed Bazaz, profesor që 20 vjet në Universitetin e Oakland-it në SHBA dhe ligjërues edhe në Fakultetin e Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë në UBT: "Kurrikulat e edukimit të lartë në SHBA dhe Kosovë pikërisht në UBT janë relativisht të ngjashme".

Ndërkaq prof. Schari Zafarpour, ligjërues në UBT dhe njëkohësisht në Universitetin e Vjenë, Krems, Eisenstadt, UCLA dhe USC në USA, etj. është shprehur: "Jo pse jam tanimë unë pjesë e UBT-së, por me të vërtetë ky universitet është i rangut të lartë dhe sigurisht në pozitë të mirë me standardet ndërkombëtare.

Dhe në këtë rast sa për ilustrim të tekstit po marr si shembull, jo të gjithë, por vetëm disa kandidatë, të cilët kanë përfunduar një pjesë të studimeve në UBT e për më tutje kanë vazhduar në universitete të Evropës. Lirshëm potencoj se në vendin tonë, e vetmja UBT-ja prej institucioneve të arsimit të lartë privatë studentëve të vet ua krijon këtë mundësi të studimit të doktoratës jashtë vendit. Kjo mundësi është ofruar për studentët e UBT-së falë marrëveshjeve të bashkëpunimit me shumë universitete ndërkombëtare. Po e marrim vetëm një citat të presidentit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizit, gjatë takimit me palët për zrytarizim të marrëveshjes me Universitetin City në Londër (Angli): "UBT-ja ka qenë gjithëherë aktive në ofrimin e mundësive dhe bartjeve të dijeve nga universitetet e njohura botërore me anë të marrëveshjeve dhe të bashkëpunimeve. Dhe një marrëveshje të tillë e kemi filluar edhe me Universitetin City, i cili do t'ua mundësojë studentëve kosovarë që studimet universitare në nivelin bachelor, master dhe në doktoraturë t'i ndjekin në UBT dhe në Universitetin City".

Implementimi i marrëveshjes ka filluar të zbatohet po në këtë vit akademik 2011/ 2012.

Studime në Austri

Në Universitetin Teknik (TU) të Vjenës në Austri, përveç mar-



rëveshjeve, shkëmbimit të stafit akademik ndër-institucional, konferencave shkencore të përbashkëta, trajnimeve etj., studentët e UBT-së mund t'u qasen edhe studimeve të mëtutjeshme. Disa studentë të UBT-së e kanë vazhduar punën në këtë drejtim dhe në këtë rast vlen të veçohet pranimit dhe diplomimi i tyre në studimet e doktoratës në universitetin në fjalë.

Dr. Binak Beqaj, i cili është edhe i angazhuar në UBT, brenda muajit prill 2011, para një komisioni të universitetit në fjalë ka mbrojtur temën me sukses dhe është shpallur doktor nga fusha e planifikimit dhe menaxhimit urban. Kurse Mimoza Dugolli, Lulzim Beqiri dhe Muhamet Ahmeti, të cilët kanë përfunduar studimet master në UBT, i kanë regjistruar në mënyrë të rregullt studimet e doktoratës.

I njëjti fat për studime jashtë vendit i ka përcjell edhe kandidatët Yllza Luftiu dhe Erden Halili, të cilët studimet themelore i kanë përfunduar në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT. Pas mbarimit të këtyre studimeve menjëherë ata patën shfaqur interesime për studime master jashtë kufijve të Kosovës, pikërisht në kryeqendrën e Austrisë në Vjenë, në Universitetin TU WIEN, në Departamentin e Arkitekturës dhe sot kandidatët në fjalë janë duke i ndjekur studimet.

Studime në SHBA

Rrezarta Veseli studimet themelore i ka përfunduar Fakultetin Shkenca Politike në UBT dhe menjëherë i ka vazhduar studimet për master në SHBA, duke aplikuar dhe fituar bursë nga KAEF - Kosovo American Education Fund, dhe me ndihmë të Zënjurta Greda. Kjo ka hyrë në studimet master në Fakultetin Edward J. Bloustein, për Planifikim dhe Politika Publike, në Universitetin Rutgers, në kampusin e New Brunswick,

New Jersey. Ajo ka diplomuar në afatin e rregullt te profesoresha Dr. Julia Rubin.

Studime në Itali

Leana Mamut e cila para tre vjetëve i kanë përfunduar studimet themelore në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Departamenti Arkitekturë, kurse menjëherë ka vazhduar studimet për master dhe ka përfunduar jo në UBT por në Universitetin "Politecnico Di Milano" në Itali, drejtimi Arkitekturë dhe diplomon me temën "Projektin urbanistik dhe arkitektonik në qytetin e Barcelonës".

Po ashtu edhe Arlinda Shaqiri, e cila para tre vjetëve i ka përfunduar studimet themelore në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Departamenti Arkitekturë, e tash është në prag të përfundimit të studimeve Master në Universitetin "Politecnico Di Milano" në Itali, drejtimi Arkitekturë.

Studime në Britani të Madhe

"UBT ofronte mundësinë e marrjes së njohurive nga një personel akademik ndërkombëtar, gjë që bëri, që unë me lehtësi të adoptohem në sistemin anglosakson të edukimit", thotë Ermal Lubishtani, i cili, pas përfundimit të studimeve të nivelit Bachelor në UBT, në Fakultetin Management, Business and Economics, ka vazhduar studimet master në Mbretërinë e Bashkuar (UK), në Staffordshire University në Business School dhe ka diplomuar në programin Msc in Economics for Business Analysis, me temën "The Structure-Conduct-Performance Relationship: The effects on industry performance: A reassessment using dynamic panel models", te prof. Iraj Hashi, një profesor i dëshmuar nga lëmi i shkencave ekonomike.

Illir Hajdini në vitin 2004 i pati filluar studimet në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, Fakulteti Management Business and Economy, drejtimin Administrim Biznesi dhe kishte diplomuar me temën "Marrëdhënie Ndërkombëtare Ekonomike". Në vitin 2007-2009 i ka përfunduar studimet e shkallës së tretë në Britani të Madhe, në "University of Sussex". Ai ka magjistruar në fushën "International Management and Innovation Management" dhe tash është kandidat për doktoraturë në Universitetin e Vjenës në drejtimin Menaxhim dhe Ekonomi.

Studime në Suedi

Vigan Sadiku studimet themelore i ka përfunduar në Fakultetin Management, Business and Economics në Universitetin për Biznes dhe Teknologji. Kurse studimet posdiplomike i ka përfunduar në Suedi në Lund University, në Fakultetin Lund School of Economics, më konkretisht ka diplomuar në MSc. Business Management and Economy, me temën "Performance Measurement System in the Shipping Industry", te prof. Olof Arëid dhe prof. Rolf Larsson.

"ERASMUS MUNDUS"

Përmes "ERASMUS MUNDUS" studime në Britani e Madhe, Gjermani, Finlandë, Irlandë, Poloni, Ruman, Shqipëri, Bosnja-Hercegovina, Kroaci, Maqedoni, Kosovë, Serbi,

UBT-ja është përfituese edhe e projektit "Erasmus Mundus", në të cilin përfshihen 16 universitete nga rajoni dhe Evropa. Prej tyre tetë nga vendet e Ballkanit, ndërsa Universiteti për Biznes dhe Teknologji është i vetmi universitet privat nga Kosova dhe rajoni që është përfitues i projektit në fjalë. Projekti është

një kontribuues i madh për katër vitet e ardhshme, siç janë bursat që ofrohen për të studiuar në vendet e Bashkimit Evropian, por edhe në rajon dhe studentët e UBT-së mund të studiojnë në këto vende.

Ja si shprehet prof. dr. Ramë Buja, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), gjatë prezantimit të projektit në hotelin "Grand" në Prishtinë: "Me kënaqësi e mora ftesën nga një institucion i arsimit të lartë, siç është në këtë rast UBT-ja, që është përfituese e një projekti 'Erasmus Mundus'. Ta përfitosh një projekt të tillë nuk është rastësi, por është e arritur në sajë të cilësisë. E përgëzoj UBT-në për punën e bërë!".

Përfituesit e bursës nëpërmjet projektit në fjalë janë këta studentë të cilët vetëm i kanë filluar studimet në universitetet e cekura më lart për studime themelore dhe master: Arian Agani, Anesa Ramaxhiku, Shkurta Berisha, Blerta Bytyci, Egzon Dushku, Fatlum Gerguri, Njomza Havolli, Haris Haxhimemmeti, Ndriçim Idrizi, Rineta Jashari, Mirsad Kosumi, Agron Krasniqi, Arnisa Kryeziu, Diana Llugaxhiu, Erodiat Llugaxhiu, can Mehmet, Lirigzona Morina, Burim Ramadan, Rina Sadriu dhe Qendresa Sopaj, po ashtu kemi edhe kandidatë të cilët janë pranuar për studime posdiplomike si Binak Beqaj.

Studime në Çeki

Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji UBT, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë qëndrimit në Pragë të Republikës së Çekisë në muajin shtator, ka zhvilluar një varg takimesh me rëndësi me krerët e institucioneve të botës universitare dhe akademike me qëllim të arritjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit ndëruniversitar me Universitetin Masarykova, Universitetin Pardubice, Universitetin Teknik të Çekisë, Universitetin e Pillzenit etj.

Studime në Turqi

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) bashkëpunon edhe me Universitete nga Republika e Turqisë pikërisht me "Universitetin Kadir Has" dhe "Universitetin Amir Sinan", një marrëveshje e tillë mes UBT-së me dyja universitete e cekura më nënshkrua gjatë muajit dhjetor të vitit të kaluar. "Natyrshisht ishte një shkëmbim shumë i mirë përvojash për ne, sepse këto universitete vërtetë kanë bërë një zhvillim të madhe dhe kane krijuar emër në fushat e studimeve të cilat ato i ofrojnë. Prandaj, është interes ynë që praktikata e mira turke të bartën edhe në Kosovë", tha Prof. Dr. Edmond Hajrizi, President i UBT-së.

STUDENTËT E UBT-SË VIZITUAN REPUBLIKËN E ITALISË



PRISHTINË, 17 MAJ 2011 - Studentët e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), gjatë muajit maj organizuan vizitë disaditore në Republikën e Italisë. Këtij organizmi ju bashkëngjiten stafi akademik dhe administrativ i UBT-së.

Studentët gjatë vizitës në fjalë në shtetin në fjalë kanë vizituar objekte me vlera historike të periudhave të ndryshme kohore dhe me stile të ndryshme të ndërtimit, dhe bukuritë natyrore dhe bregdetare. Ata, po kështu kanë vizituar edhe qytete të ndryshme si Riminin, Venedikun, kryeqendrën Romën, Firencen, vizituan edhe kompani të ndryshme biznesore dhe ndërtimore.

Studentëve të UBT-së komoditet të këndshëm, ju ofruan dhe i mirëpritën edhe hotelet e ndryshme, e sidomos në kryeqytetin e Italisë.



STUDENTJA E UBT-SË RRËMBEU ÇMIMIN NË SHOUN "TALENTI MULTIKULTUROR" NË FINLANDË

Prishtinë, 16 nëntor 2011- Lirigzona Morina, studente e UBT-së, e cila ka fituar bursë për vazhdimin e studimeve përmes projektit "Erasmus Mundus" në Universitetin Lappeenranta të Finlandës, e la gojëhapur publikun finlandez me zërin e saj në shoun "Talentit multikulturor", e cila prej asaj konkurrence mjaftë të gjerë rrëmbeu çmimin e tretë.

Juria profesionale e vlerësoi atë si një personalitet të fortë dhe me një zë të bukur dhe krenare në skenë më pas i sugjeruan që të vazhdonte karrierën e saj në këndim.

Pas marrjes së çmimit asaj i kërkuan të përformonte një pjesë të shkurtër të një kënge prej vendit nga vjen dhe aty për aty zgjodhi Himnin Kombëtar "Rreth flamurit", etj.

UBT është përfituese e projektit "Erasmus mundus", shumë studentë të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), kanë fituar bursa të plota studimi për vitin e ri akademik 2011-2012 në të gjitha nivelet e studimit si bachelor, master dhe të doktoratës, të cilët kanë filluar mobilitetin e tyre në universitetet më prestigjioze të vendeve të Bashkimit Evropian, dhe po e citojmë edhe njëherë se njëra ndër fitueset e bursën në fjalë është edhe Lirigzona Morina.



PROF. DR. ZEJNULLAH GRUDA

GERNIKA E PIKASOS

Pablo Pikaso (1881-1973) është një ndër artistët që i ka kontribuar më së shumti zhvillimit të artit modern. Pikaso ka krijuar në të gjitha gjinitë (llojet) e artit: pikturë, vizatim, litografi, bakërlakim (gravurë), skulpturë, keramikë. Ka bërë ilustrime për libra, pllakate, dekore dhe kostume, e është sprovuar edhe në shkrime. Duke krijuar Pikaso ka ndërruar ngjyrat që ka përdorur (ngjyrat predominante) duke shënuar kështu periudha të veçanta (Periudha e kaltërt, Periudha e kuqe), ka ndërruar stilet: realizmi klasik – Mannerizmi, stili neoklasik dhe surrealizëm, por kubizmi të cilin Pikaso e ka inicuar bashkë me Braque si drejtim ka qenë pasion i tij i përhershëm. Pikaso ka lënë pas vetes më shumë vepra se cilido artist tjetër gjatë tërë historisë: ka hapur rrugë të reja të shprehjes, ia ka lënë një vull të pashlyeshme të krijimtarisë artistike të shekullit XX. Fatkeqësia e Gernikës është bërë simbol për krimin mbi popullsinë e pambrojtur civile dhe luftës për idealet e lirisë.

Veprat e Pikasos kanë hasur në interesim të jashtëzakonshëm, kurse Gernika është padyshim vepra që ka nxitë më së shumti kureshtje dhe ka shkaktuar më së shumti diskutime. Çka ka përmbytur? Cilat simbole i ka shfrytëzuar? Çfarë mesazhi ka sjellë etj., janë bërë tema të interesit të gjerë. Autori i këtyre rreshtave është interesuar për këto, sepse Gernika është më shumë se sa një pikturë. Ajo është histori, ajo është armë e fortë kundër luftës dhe në fund ajo është dëshmi e angazhimit patriotik dhe pro-

gresiv të artistit të madh për çka padyshim ka hyrë në radhën e veprave të pavdekshme.

1. Inspirimi për Gernikën

Më 1936-1939 në Spanjë zhvillohej lufta civile midis forcave progresiste dhe forcave të forta të reaksionit që është një ndër dramet më tragjike për paqen botërore. Në një anë ishte kuadri komandues i armatës, kleri, pronarët e mëdhenj të tokës, të cilëve më vonë i janë bashkuar edhe përkrahësit e tjerë të së djathtës nga radha e qarqeve fashiste borgjeze. Në anën tjetër ishin forcat progresive të cilat i bënin punëtorët, fshatarët e varfër, zanatçinjtë, borgjezia e imët dhe intelijenca progresive të cilëve iu prinin komunistët dhe republikanët.

Në këtë luftë fati ka dashur që Pikaso të luajë një rol unik. Në fillim të vitit 1937 qeveria spanjolle e ka emëruar drejtor të Prados në Madrid që është koleksion kombëtar i artit. Kjo ka qenë shprehje e mirënjohjes ndaj piktorit, por njëkohësisht edhe shprehje e brengosjes për fatin e veprave artistike, që autorëve të tyre dhe Spanjës i kanë sjellë famë të përjetshme.

Disi në atë kohë përgatitje ekspozita botërore në Paris, dhe qeveria e Madridit e luti Pikason që të kontribuonte në rregullimin e pavilonit spanjoll. Atëherë piktorit i lind ideja (duke e konsideruar si të mirë) që të shfaq qëndrimin e vet ndaj luftës, sepse lajmet që vinin nga fronti i luftës sikur e ftonin që të përzihet në konflikt duke përdorur mjetin që kishte pikturën si armë. Dramatika e

momentit që ka jetuar Spanja's ka mund ta linte indiferent.

Në këtë luftë nacionalistët baskë janë vënë në anën e rendit republikan, duke deklaruar haptazi se në luftë midis popullsisë dhe fashizmit dhe midis republikës e monarkisë, vihen në anën e popullsisë dhe të republikës. Duke u nisur nga ky përcaktim qeveria e Baskisë (e përbërë nga nacionalistët me të cilët bashkëpunonin komunistët baskë) i kanë vënë komandës ushtarake republikane në dispozicion 25.000 luftëtarë dhe 12.000-15.000 pjesëtarë të milicisë. Për këtë atdheu i baskëve Baskija është bërë një ndër objektivat kryesore të fashistëve. Në fillim të vitit 1937 ka filluar ofensiva në Navare, me pjesëmarrjen e kryengritësve fashistë, të cilët i përkrahnin marokenët dhe italianët, e nga ajri „Legioni Condor“ i Gjermanisë hitleriane.

Pas rënies së Mandragonit, Eibarit dhe Durangos radha i kishte ardhur Gernikës, qytezës që kishte qenë qendër e vjetër shpirtërore, kulturore dhe politike e baskëve, e që si qytet i shenjtë simbolizonte lirinë shekullore të tyre. Më 26 prill të vitit 1937 aeroplanët gjermanë të njësishë Kondor, që ishin dërguar për ta përkrahur gjeneralin Franco, për disa orë e bombardojnë qytezën. Meqë ishte ditë pazari, rrugët e ngushta dhe sheshet e hapura u bënë varreza masovike të popullsisë së pafajshme, kurse qyteza Gernika u bë një ndër viktimat para të fashistëve.

Shërbimi propagandues i Frankos për t'i ikur përgjegjësisë për viktimat dhe shkatërrimet e shumta dërgonte në botë lajme të rrejshme se gjoja Gernikën e kanë shkatërruar vetë banorët e

saj. Mirëpo korrespondentët e luftës të njëjtën ditë e njoftuan botën me të vërtetën.

Me të marrë vesh për këtë Pikaso porositi një pëllhurë të madhe 3x8 metra dhe filloi punën me veprën, që është akuzë dhe dëshmi për fytyrën e vërtetë të fashizmit në Spanjë. Kështu kjo ngjarje e vërtetë (shkatërrimi i qytezës së vjetër dhe masakrimi i popullsisë civile nga forcat fashiste) e inspiruan piktorin të shpreh indignacionin e thellë që tek ai kishte shkaktuar shkatërrimi i Gernikës.

2. Përmbyrtja e Gernikës

Gernika është bërë për afro dy muaj (maj-qershor të vitit 1937). Asaj i kanë paraprirë 61 skica në të cilat paraqiten personazhet kryesorë: gruaja me fëmijë të vranë në përqaftim duke vajtuar, kali i plagosur dhe i rraskapitur, demi, etj. Kështu deri sa lufta merrte përpjestime gjithnjë e më të mëdha dhe shqetësuese, ndërsa gjenerali i rebeluar dhe kauza e tij përparonte mbi trupat dhe gjakun e demokratëve, në pëllhurat e vogla ndërroreshin simbolet e dhunës dhe të viktimave: demi, kali i plagosur, nëna me fëmijë të vdekur, etj.

Dhuna dhe pasojat e saja bëheshin temë kryesore e piktorit kurse kali, demi, luftëtari e gruaja përbënin një tërësi të simboleve të cilët me vdekjen e tyre, lëndimet, vajin, klithjet, tregonin qartë për shkatërrimet dhe vuajtjet e popullit spanjoll. Rasti i Gernikës kishte treguar qartë se viktimat binin jo vetëm nga rrethi i luftëtarëve, por gjithnjë e më tepër edhe nga radha e popullsisë civile dhe piktorit ngrit zërin kundër kësaj.

Gernika është tablo e bërë me ngjyrë të bardhë, të zeze dhe të murmë. Në të nuk ka ngjyra të shkëlqyeshme që janë karakteristike për shumë vepra të tija. Për këtë arsye kjo mënyrë jo e zakonshme e shprehjes që rrallë është aplikuar nga piktori ka nxitur mjaft diskutime midis autorëve që kanë shkruar për Gernikën. Çka e ka shtyrë Pikason të veprojë kështu? Një pjesë këtë e lidh me tonet e gazetës, prej të cilës Pikaso për herë të parë kuptoi për tragjedinë e Gernikës. Të tjerët mendojnë se ngjyrat e thjeshta dhe të errëta është dashur ta transmetojnë më së miri mesazhin botës për gjendjen në Spanjë, sepse ato ndihmojnë për të forcuar përshtypjen katastrofale të tregimit. Si do që të jetë Gernika ka qenë shprehje e emocioneve që i ka shkaktuar shkatërrimi i qytezës baske dhe fatkeqësia e popullit të saj.

Në kuadër paraqitet nga ana e djathtë gruaja në shtëpi që digjet duke kërkuar ndihmë. Viktimat e tjera gjysmë të zhveshura ikin nëpër errësirë. Një grua vrapon nga shtëpia nëpër natën e errët me një llampë vaji në dorë. Në qendër është kali i plagosur që është strukur nga dhembjet. Nën të janë të shpërndara pjesët e trupit të një ushtari pa kapelë që me gjasë duhet të jetë civil, i cili mbanë në dorë një shpatë të thyer. Në anën e epërme nga e majta është një dem i cili shikon tërë këtë ngjarje i palëvizshëm dhe krejt idiferent (si i painteresuar). Afër demit është një nënë që me kokë të ngritur e vajton fëmijën e vdekur që e mban në duar. Një llampë në qendër e ndriqon



nga lartë këtë kataklizëm, frikën dhe pësimin e viktimave të luftës.

3. Simbolet e Pikasos

Nga ekspozimi i parë Gernika është bërë objekt i kontravertave të mëdha. Çfarë mesazhi sillte Gernika? Si duhet kuptuar atë? Çfarë domethënie kishte? Çka përfaqësojnë simbolet e përdorura? etj.

Vetë Pikaso në një bisedë me Kristian Zervosin është shprehur kundër përpjekjes që të kuptohet pikturimi. „Pse njerëzit e duan natën, lulet, krejt atë që i rrethon“, pyeste Pikaso „e jo përpjekjen që ta kuptojnë? E përse i përket pikturimit, këtë dëshirojnë ta kuptojnë“.

A përfaqëson demin dhunën apo diktatorin Franko dhe kastën e tij ushtarake? A simbolizon kali i plagosur njerëzimin që pëson? Çfarë domethënie psikologjike duhet të kenë simbolet?

Pikaso nuk duhet domosdo të ketë qenë i vetëdijshëm për kuptimin e tyre, megjithëse ai nuk e mihon rolin e simbolizimit në historinë e artit. Në vitet që i kanë paraprirë luftës civile, Pikaso sikur ka parandie tragjedinë që po afrohej.

Në veprën „La Minotauromaquia“ (1935) janë paraqitur demin, kali i plagosur, femra toreadore, drita, pëllumbi, etj. Temë kryesore e tij ishte legjenda e përgjeshme mbi luftën midis dritës dhe errësirës, që pasqyrore qartë se trurin e piktorit e kishin kapluar personazhet që simbolizojnë tërbimin, dhunën, dhembjen, vuajtjen, trishtimin, që janë përcjellës të rregullt të luftës, e që pak më vonë do të bëheshin realitet i Spanjës. Demin, kali, drita, vuajtja, do të paraqiten tërësisht në Gernikën. Por çfarë domethënie kanë këto? Vetë Pikaso, duke bërë fjalë për këto ka thënë: „Demin është dem dhe ky kal është kal. Publiku që e shikon pikturën duhet të shohë në dem dhe në kal simbolet të cilat i interpreton ashtu si ata i kuptojnë. Është e publikut të shohin çka

dëshirojnë të shohin“. Sipas Pikasos ata që përipiqen të shpjegojnë një pikturë, në të shumtën janë në rrugë të gabuar, sepse si mund të pritët që një shikues ta përjetojë pikturën e tij, ashtu siç ai e ka përjetuar. Meqë piktura rregullisht paraqitet shumë më herët se ç'është pikturuar, atëherë si është e mundur që dikush të depërtojë në ëndërrat (përfytyrimet) e tij, instiktet, dëshirat dhe mendimet, të cilave u është dashur kohë që edhe vetë të marrin formën dhe të dalin në sipërfaqe, e aq më pak të kuptojë atë që ka pikturuar.

Ata që kanë shkruar për Gernikën, në dem çdo herë kanë parë simbolin e dhunës, në kal popullin e përvuajtur, e Gernikën si diçka që është më shumë se një dokument i Luftës civile të Spanjës. Në favor të kësaj shkon fakti se Gernika është pikturuar si reagim i drejtpërdrejt në bombardimin e qytezës baske Gernika. Kësaj tek e fundit i përgjigjet interpretimi i vet Pikasos, i cili në një letër dërguar Simon Tery pati shkruar:

„Çka mendoni ju se është artisti? Një i çmendur (i paafët) që ka vetëm sytë nëse është piktor, ose vetëm veshët nëse është muzikant, ose vetëm harfin në zemrën e vet nëse është poet, ose madje vetëm muskujt nëse është boksier? Përkundrazi, ai është në të njëjtën kohë qenie politike, i ndieshëm përherë në atë që i copton zemrën, në ngjarje të tmerrshme ose të lumtura, të cilave ai u përgjigjet në çdo mënyrë... Si do të ishte i mundur mosinteresi për të tjerët... Jo, piktura nuk bëhet për t'i dekoruar apartamentet. Ajo paraqet një instrument të luftës për sulm dhe mbrojtje kundër armikut“. Kështu Gernika është pikturë që akuzon, përkujton, brohorit: është sintezë më e mirë e emocioneve artistike dhe ideologjike (Oto Bihali Merin). Vetë Pikaso njëherë kishte thënë, se „demin nuk është fashizmi, por brutaliteti dhe egësia... kali e përfaqëson popullin... Gernika është pano simbolike... alegorike. Kjo është arsyeja që unë e kam përdorur demin, kalin e të tjerat. Panoja është për shprehjen definitive dhe zgjidhjen e problemeve dhe kjo është pse unë kam përdorur simbolizimin“.

„Në Gernikën unë kam shprehur neverinë (tmerrin) tim për kastën militariste që e ka zhytur Spanjën në detin e vuajtjeve dhe vdekjes“, pati thënë Pikaso.

4. Kthimi i demokracisë – kusht për kthimin e Gernikës

Gernika që prej momentit të parë ishte bërë objekt i një interesimi të jashtëzakonshëm. Më 1939 Gernika ka qenë e ekspozuar në Nju-Jork në Muzeun e arteve moderne.

Rrethanat në Spanjë kanë ndikuar që Gernika të mbetet në Nju-Jork afro dyzet vite si depozitë i piktorit, ngase Pikaso kthimin e saj në Spanjë e ka kushtëzuar me rivendosjen e demokracisë. Shumë herë kishte përsëritur se Gernika dhe 61 skicat për të, i takojnë qeverisë republikane, prandaj përderisa fashistët të jenë në pushtet Gernika duhet të mbesë jashtë Spanjës.

Gjatë këtyre viteve kthimi eventual i Gernikës ka qenë objekt i bisedave, letrave, mendimeve, etj. midis aderuesve të piktorit, veprës së tij dhe çështjes progresive për të cilën ai është angazhuar me aq përkushtim. A do të kthehet Gernika në Spanjë, siç kërkohet disa studentë dhe profesorë, apo edhe më tej do të mbetet larg Spanjës? Për këtë, qëndrimet ishin të ndara. Disa mendonin se Gernika „duhet t'i kthehet Spanjës menjëherë, sepse asaj (Spanjës) i takon“, dhe përfaqëson armë në realizimin e qëllimeve politike. Të tjerët mendonin se kthimi i Gernikës do të përfaqësonte „fitore për regjim“.

Në tërë këtë e paqartë ka qenë qysh do të vepronte qeveria frankiste nëse piktori kishte për të pranuar që Gernika të kthehet në Spanjë. Disa mendonin se qeveria e Frankos këtë s'do ta pranonte, meqë kjo do t'i gjasonte situatës sikur vrasësi të kërkohet ta ekspozonte trupin e viktimës për nevojë të ekspozitës. Në këso rrethanash, Pikaso ka qenë i vendosur se Gernika duhet të mbetet atje ku është, por edhe i vetëdijshëm se ajo një ditë do të kthehet në Spanjë „sepse Gernika, sikurse e di çdokush, është populli i Spanjës“.

Në fund të viteve të shtatëdhjeta në Spanjë ka filluar të kthehet demokracia. Lajmëtarët e saj janë kthimi i Gernikës dhe Dolores Ibarurit dhe shumë demokratëve tjerë.

5. Epilogu: triumfi i së vërtetës

Pas kapitullimit të Francës më 1940, Pikaso mbeti në studion e tij parisienë në rrugën Grands-Augustins. Oficerët gjermanë kur kishin kuptuar se është fjala për një artist kërkuan nga ai t'i shohin punimet e tij dhe ai iu dha një fotografi të Gernikës. Njëri nga ata e pyeti: „A e keni bërë ju këtë?“. Pikaso ishte i prerë në përgjigje: „Jo, ju e keni bërë“.

Më 26 prill të vitit 1997 në 60-vjetorin e bombardimit të Gernikës, kryetari i Gjermanisë Roman Herzog i kishte dërguar një mesazh të mbijetuarëve të Gernikës në të cilën shkruante: „Më 26 prill 1937 Gernika u bë viktimë nga sulmi ajror i legjionit „Condor“ që bëri emrin e qytetit tuaj simbol të luftës së vrazhdë kundër popullatës së pambrojtur. Dita e Gernikës dhe vuajtjet njerëzore... prej atëherë mbetën pjesë të përbashkëta të kujtesës së popujve tanë. Do të doja të ballafaqohem me të kaluarën dhe në mënyrë eksplicite të pranojë fajin dhe pjesëmarrjen e pilotëve gjermanë. Juve që mbijetuat sulmin si dëshmitar të tragjedisë së bërë, ua dërgoj këtë letër si komemoracion, si ngushëllim... juve që ende bartni plagët e së kaluarës, ofrojë dorën time si lutje për pajtim“.

P.S. Ky punim pos epilogut është publikuar për herë të parë në „Rilindja“ më 2 nëntor të vitit 1985 kurse si i këtillë është publikuar në Revistën e studentëve Euro Idea Numër 13 – prill 2006 të UEJL në Tetovë.



ARTI DHE KULTURA NË UBT

Përveç arritjes në shkencë, botime, hulumtime, marrëveshje dhe bashkëpunime me universitete më prestigjioze, infrastrukturë dhe teknologjinë më moderne, Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) ndihmon në zhvillimin e botës së artit dhe kulturës në përgjithësi.

UBT në krye me departamentin e Arkitekturës që prej fillimit të punës organizon çdo vit ekspozitë tradicionale, dhe pjesëmarrja në këtë ngjarje është mjaft e madhe nga ana e studentëve që paraqiten me të gjitha gjinitë (lloje) e artit: pikturë, vizatim, litografi, bakërlakim, skulpturë, keramik etj. Në këtë organizim nuk mungon as pjesëmarrja e zyrtarëve të lartë të fushës së artit dhe kulturës vendore dhe ndërkombëtare.

Vlen të veçohet se në UBT ka studentë të talentuar edhe në fusha të tjera në atë të artit të muzikës dhe shumë prej tyre i gjejnë në skenën muzikore të vendit, që me bendet e tyre muzikore kultivojnë muzikë të vjetër të traditës tipike shqipe dhe të vendeve të huaja. Këta studentë janë pjesëmarrës edhe në organizimet e UBT-së.

Më shumë përkushtim duhet të përmendet studentja e UBT-së Marigona Shala, e cila me 20 krijimet e saj artistike-pikturë do të paraqitet në këtë aktivitet madhor.

„Unë vazhdimisht jam prezentë me piktura nëpër të gjitha ekspozitat kolektive që organizohen në Kosovës, po ashtu nëse më jepet mundësia edhe jashtë vendit, por ftesën e UBT e pres me padurim dhe do paraqesë të gjitha pikturat e përzgjedhura“, tha Marigona Shala për gazetën „UBT News“.

Të gjitha krijimet mund të shihen ekspozita të pikturave të ndryshme, skulptura të shkencëtarëve, filozofëve dhe shkrimtarëve më të mëdhenj që prej se ekziston njerëzimi në hollin dhe në sallën e konferencave të UBT-së.





UBT DHE UNIVERSITETI I TIRANËS ORGANIZUAN KONFERENCË NDËRKOMBËTARE

TIRANË, 12. 06. 2011- Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës (UT) organizuan konferencën dyditore shkencore në nivel ndërkombëtar me temën "Sistemet e Informacionit dhe Teknologjitë dhe rëndësia e tyre në zhvillimet ekonomike". Konferenca u organizua nën patronazhin e Akademisë të Shkencave të Shqipërisë, dhe u mbajt në ambientin e hoteli "Rogner", në kryeqendrën e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.

Përveç krerëve të të tria institucioneve organizatore, si Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Rektori i Universitetit të Tiranës (UT), Dhori Kule, dhe Kryetar i Akademisë së Shkencave (ASHK), Gudar Beqiraj, në hapjen solemne morën pjesë edhe përfaqësues të lartë të Republikës së Shqipërisë si ish-ministri i arsimit dhe njëkohësisht Ministër i Inovacionit dhe Teknologjisë, z. Genc Pollo.

Duke përshëndetur konferencën, ministri Pollo vlerësoi lart bashkëpunimin midis institucioneve shkencore të të dyja shteteve, bashkëpunimi i cili duhet të intensifikohet edhe më tej, në mënyrë që të shkëmbehen përvojat dhe të arrihen rezultate edhe më të mëdha në hulumtimet dhe inovacionet shkencore, në mënyrë që studentët dhe ekspertët shqiptarë nga të dy shtetet të ecin krahas kolegëve të tyre nga shtetet më të zhvilluara botërore në fushën e teknologjisë.

Po ashtu konferencën e përshëndetën edhe përfaqësues dhe studiues të universiteteve të ndryshme të Evropës si Anita Mirijamdotter nga Universiteti Linnaeus, Peter Kopacek, Vienna University of Technology, Austria dhe UBT, etj.

Për dy ditë më radhë në konferencë u mbledhën një numër i madh i pedagogëve, studiuesve dhe ndërmarrjeve të fushës së IT-së nga shumë vende të rajonit dhe Evropës. Janë paraqitur mbi 150 punime shkencore, dhe u kumtuan në disa sesione paralele gjë që i dha konferencës një karakter shumë të rëndësishëm me peshë shkencore. Paraqitësit e kumtesave, përveç nga Shqipëria dhe Kosova, ishin edhe nga Suedia, Gjermania, Austria, Irlanda, Italia, etj.

Prof. Dr. Kozeta Sevrani, organizatore e Konferencës dhe përgjegjëse e Departamentit Matematikë, Statistikë dhe Informatikë e Zbatuar në UT, përveç që i përshëndeti të pranishmit ndër tjera tha: "Tashmë të gjithë e dimë që ndër prioritetet e qeverisë shqiptare është zhvillimi i



shqipërisë së informacionit. Këto prioritetet nuk mund të kuptohen pa nxitjen e inovacioneve dhe investimeve të rëndësishme në edukim dhe kërkim shkencor. Gjithashtu, kjo nënkupton dhe ofrimin e kurrikulave që çojnë në hartimin e njohurive në fushën e TIK. Për këtë arsye, të gjithë aktorët kryesorë që lidhen me zhvillimin e TI në vend duhet të shkrijnë idetë, forcat, kapacitetet dhe fuqitë e tyre për të qenë pjesë e kësaj shoqërie si dhe për t'i bërë ballë sfidave të së ardhmes".

Departamenti ynë, shtoi ajo, nëpërmjet kësaj konference synon të vazhdojë të kontribuojë për përmbushjen e nevojave që kanë akademikët, kërkuesit, lektorët e studiuesit e fushës, për të ndarë mendimet, idetë, eksperiencat dhe punimet e tyre. Konferenca synon të forcojë një platformë tashmë të vendosur që në konferencën e mëparshme, ku të diskutohen problemet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në vend si dhe impakti i elementeve të ndryshëm të saj në zhvillimin e ekonomisë e shoqërisë në përgjithësi. Së fundi, pjesë e fokusit të kësaj konference do të jetë dhe zhvillimi i tregut informatik, ku aktorë të këtij tregu janë të mirëpritur të japin opinionin dhe mendimin e tyre kritik në lidhje me të.

Po ashtu i Presidenti i UBT-së, dhe njëkohësisht organizatorë i konferencës, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, duke vlerësuar lart rëndësinë e kësaj konference dhe bashkëpunimin me institucionet më të rëndësishme akademike në

Shqipëri, tha se kjo konferencë është edhe një rezultat i punës së pandalshme të UBT-së në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar. Kjo konferencë, tha ai, hyn në vargun e një varg konferencash ndërkombëtare që ka organizuar UBT në Prishtinë apo ku UBT ka përfaqësuar Republikën e Kosovës në të katër anët e globit, duke krijuar ura bashkëpunimi me institucionet më prestigjioze ndërkombëtare, si dhe duke u krijuar mundësinë profesorëve dhe studentëve të UBT-së që të njihen me kolegët dhe përvojat e institucioneve akademike nga e mbarë bota.

Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, gjatë hapjes solemne të punimeve të konferencës, ka thënë se njerëzimi kurrë nuk ka jetuar më mirë se sot, megjithëse në të kurrë nuk ka pasur diferenca më të mëdha në mes të sistemeve shkencore, shoqërore dhe teknike. "Në qoftë se i marrim në konsideratë zhvillimet shkencore dhe teknike, kualiteti i jetës do të ishte gjithnjë më i mirë. Por, siç shihet, është shumë vështirë të krijohet një strukturë shoqërore që do të mundësonte zhvillimin e këtyre përparësive", ka deklaruar z. Hajrizi, duke shtuar se në botë ka zhvillim të madh e të shpejtë të shkencës dhe teknologjisë në atë masë sa njerëzimi nuk e ka përjetuar në herët. "Ne sot po kërkojmë një model që do të përshinte të gjithë trendet e zhvillimit, si p.sh, jemi duke e kërkuar "të menduarit e orientuar në sistem", për të menduar

në qasje ndaj sistemit, biznes excellenca, sistemin e integruar të menaxhmentit, menaxhimin riskut, inovacioni, zhvillimin e qëndrueshëm, stabilitetin e sistemeve dhe përgjegjësin shoqërore", ka deklaruar Hajrizi.

Ai falënderoi sponsorët e kësaj konference, akterë të njohur të tregut shqiptar të Teknologjisë së Informacionit dhe shërbimeve të tyre, të cilët me dashamirësinë e tyre ofruan mbështetjen e tyre për zhvillimin e kësaj konference dhe konkretisht: ABCOM, AVIS, Microsoft, iKUBINFO Software Solutions, Tetra & Computer and Copier Systems (CCS Group), Institutin e Modelimeve në Biznes, Shoqata AITA, DM Consulting Services, EPICT, Bilanc, Konsort

Po ashtu në konferencë më punime e tyre hulumtuese nga fusha e cekur me lartë u paraqitën edhe një varg studiuesish të rinj të të dyja universiteteve organizatore si të UBT-së dhe UT-së, si studentë dhe profesor.

Prof. Besnik S Skenderi prezantoi punimin për zbatimin e veglave elektronike në planifikimin e projekteve. Kjo është temë interesante sepse 60% e projekteve të iniciuara në botë dështojnë dhe një prej problemeve që ndikon në dështimin e projekteve është komunikimi i dobët ndërmjet menaxherit të projektit dhe anëtarëve të ekipit si dhe mosplanifikimi adekuat i projektit. "Me zbatimin e veglave si MS projekt evitohet problemi i komunikimit dhe planifikimi dhe

përcjellja e progresit bëhet me e lehtë. Për këtë punim është bërë një analizë në sektorin publik dhe privat në Kosovë dhe rezultatet janë krahasuar me analizat e bere jashtë Kosovës nga hulumtuesit e tjerë", tha Prof. B. Skenderi gjatë prezantimit të hulumtimit të tij para shumë të pranishmëve të huaj de vendorë. Po ashtu edhe Dr. Petrit Shala, njëkohësisht edhe ligjëruese në UBT prezantoi punimin për rrjetat dhe teknologjitë e sigurisë E-Comerece.

Sherif Hyseni, student në UBT në master në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike u paraqit me hulumtimin "Multi Agjenti System" (MAS), që është një term që mund të përdoret për qëllime të ndryshme në fushën e Robotikës ose Mehatronikës.

"Një Sistem Multi - Agjent (MAS) është një sistem i përbërë nga shumta agjentë të cilët bashkëveprojmë me një inteligjencë. Multi-Agjenti i Sistemit mund të përdoret për të zgjidhur problemet që janë të vështirë ose e pamundur për një Agjent Individ ose një Sistem Monolit për të zgjidhur", citoi z. Hyseni, duke cituar se fokusi kryesor i këtij publikimi do të jetë të përfaqësojë "MAS" përmes Robot Soccer, duke përfshirë një përshkrim në lidhje me lojën e Robot Soccer, kërkesat, rregullat, qëllimet dhe versionin e ardhshëm të kësaj loje.

Po ashtu edhe Kushtrim Dragusha, student në UBT u paraqit me hulumtimin "Impakti i teknologjisë mobile në sjelljen e tregtisë moderne dhe forma të reja të mendimit dhe të bërit biznes. "Evolucioni i teknologjisë mundëson zhvillimin në rrugët e ndryshme të arritjes së caktuar për transaksionet elektronike", tha ai.

Prezantimet e studenteve të UBT -së vazhduan ku me pas u paraqitën si: Samir Jupa me punimin "Adoption of E-Banking", Yllka Kusari me punimin "Internet and Infrastructure for a driven servile", Merita Beka dhe Ganimete Perquku me punimin "Mobile Ad Hoc Networks" dhe Selman Haxhijaha me punimin "Implementing Microsoft Internet Security and Acceleration Server - ISA 2006".

Konferenca i përmbylli punimet me konstatimin e për-bashkët se ngjarje të tilla të nivelit ndërkombëtar shënojnë edhe një të arritur të madhe të UBT-së dhe institucioneve partnere në Shqipëri, bashkorganizatore të konferencës, si dhe dëshmojnë nivelin e lartë të zhvillimit në këtë fushë, duke qenë të barabartë me institucionet më prestigjioze botërore.

UBT NIKOQIR I PANAIRIT TË STIKK-ut

Prishtinë, 26 prill 2011 – Në kuadër të bashkëpunimit të Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës (STIKK) me institucionet edukativo-arsimore, me qëllim të zbutjes së papunësisë në Kosovë, gjatë këtyre ditëve STIKK organizoi panairin e parë të punës u paraqit edhe në ambientet e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Në ceremoninë e hapjes së panairit morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme të vendit, profesorë, studentë, etj.

Panairi u organizua nga STIKK dhe synimin kryesor e kishte të prezantojë para studentëve dhe të interesuarve të tjerë mundësitë e punësimit në disa prej kompanive të sektorit të TI-së në Kosovë.

“Qëllimi i panairit është që të promovojë dhe menaxhojë kërkesën e të gjitha palëve të interesit për vlerën më të madhe të çdo kompanie, njeriun dhe punëtorin”, është shprehur znj. Vjollca Çavolli, drejtoreshë e STIKK në lidhje me panairin e punës dhe rëndësinë e tij.

Në kuadër të panairit të punës u prezantuan këto kompani si: RROTA, ASSECO,

Cactus, EKONET, Frakton, ITBM Group, ITEG, Logistics Plus, etj.

Pasi vetëm UBT njihet në vend dhe më gjerë për cilësinë dhe zhvillimin e Fakultetit të Mekatronikës, program i vetmi në vend dhe rajon, gjithashtu edhe për Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, nuk mungoi as pjesëmarrja e studentëve të këtyre drejtimeve studimore.

Anesa Ramaxhiu, studente në UBT dhe pjesëmarrëse në panair, tha: “Të gjitha kompanitë prezente ishin të nivelit të lartë, por unë personalisht dhe disa kolegë të mi aplikuaam për punësim në kompaninë “Asseco” dhe “ITTEG” nga e cila mora informacione të hollësishme dhe të mjaftueshme. Në bazë të bisedave që zhvilluam me përfaqësuesin e kompanisë në fjalë ofronin mundësi të ndryshme punësimit”, tha Ramaxhiu. Po ashtu, edhe Lirigzona Morina, studente në UBT, shfaqti interesim në kompaninë “EKONET” dhe në “Frakton”, kurse Nasuf Isufi në kompaninë “Cactus”.

Përfaqësuesit e kompanisë pjesëmarrëse para të interesuarve prezantuan një lloj ligjëratë dhe më shumë u fokusuan të produktet që ofrohen te klienti, shtrirjen, historiatin.



UBT ORGANIZOI CEREMONI PËR PREZANTIMIN E PROJEKTIT FINAL PËR MENAXHIMIN E ZONAVE EKONOMIKE NË KOSOVË

DY MODELE PËR MENAXHIMIN E ZONAVE EKONOMIKE NË KOSOVË

Prishtinë, 04 korrik 2011- Pas shumë vizitave të bëra me karakter studimor në kryeqendrat e shteteve të rajonit, Evropës dhe nëpër botë, nëpër parqe e kompani më të mëdha teknologjike të vendeve të cekura, eksperiencia të marra dhe të prezantuar, organizuar konferenca, debate e punëtori studimore nga njohës dhe përfaqësues të institucioneve akademike e publike, vendore dhe ndërkombëtare, dhe pas një viti pune të pandërprerë etj., sot në një ceremoni rasti, organizuar në ambientin e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), në Prishtinë, u shpalo raport final i projektit “Menaxhimi i zona ekonomike në Kosovë”, dhe palët përpiluese dolën me dy modele rekomanduese: Kompania publike për menaxhimin e zonave ekonomike dhe Kompania private për menaxhimin e zonave ekonomike në Kosovë.

“Qëllimi i këtij projekti është menaxhimi modern i zonave ekonomike, për të ofruar ambient të përshtatshëm për zhvillimin e bizneseve, komform standardeve më të larta evropiane dhe ndërkombëtare, që do të ndikojnë direkt në zhvillimin e rajonit dhe të Republikës së Kosovës”, tha para të pranishmëve presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Ai më tej foli rreth ecuresë se si ka ardhur deri te rekomandimet finale, duke e cituar vizionin e projektit, faktorëve ligjorë, analizat të cila janë realizuar nga UBT dhe grupit punues, përfshirje e gjerë



e ekspertëve të institucioneve të ndryshme në Kosovë, vizita studimore, praktikat hulumtuese dhe në fund paraqiti modelet e rekomanduara që i cekëm më lartë.

Drejtori i Agjencisë së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, Naser Grajqevci, tha se “kemi bërë një hap që t’i tërheqim të gjitha zonat urbane, t’u lejojmë njerëzve ta shfrytëzojnë dhe t’i vendosin bizneset ku më të vërtetë bëhet biznes dhe në çdo moment të përkrahjet komuniteti në fjalë me një infrastrukturë të mjaftueshme dhe 24 orë në punë”.

Raportin e përshëndeti edhe Bernar Nikaj, këshilltar i lartë politik dhe Shefi i kabinetit në MTI, i cili ceku prioritete të punës së MTI që në vazhdimësi t’i fuqizojë zonat ekonomike të vendit. “Unë besoj se sfida jonë e përbashkët që në kohët në vijim është t’i zhvillojë këto zona që bizneset t’i gjejnë

me kushte sa më të mira për të operuar. MTI është zotuar për një ambient sa më të mirë biznesore, në përgjithësi në gjithë territorin e Kosovës e veçanërisht në vendet ku zhvillohet më shumë ekonomia. Për ne është shumë e rëndësishme involvimi i një institucioni shkencor si është UBT”, citoi z. Lika.

Pjesëmarrës në ceremoni gjatë prezantimit ishin zyrtarë të lartë të institucioneve si: MTI-AMNVM, ZKM, MEF, MTI-AMNVM, MTI-AMNVM, MTI-APIK-MTI-MAPL, Asociacioni i Komunave, Qendra për Zhvillim Regjional, Oda Ekonomike e Kosovës, Aleanca Kosovare e Biznesit, Oda Ekonomike Amerikane, Banka Botërore, etj.

Projektin në fjalë është iniciuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe implementuar dhe koordinuar UBT-ja.

UBT PËRFAQËSOI KOSOVËN NË KONGRESIN E IFAC NË ITALI

PRISHTINË, 02 SHTATOR 2011- Universiteti për Biznes dhe Teknologji – UBT së bashku me 50 shtete të ndryshme të botës, prej 29 gushtit deri më 2 shtator, kanë zhvilluar punimet e Kongresit Botëror XVIII me radhë të Federatës Ndërkombëtare të Kontrollit Automatik, IFAC.

Në një sesion të veçantë, menaxhmenti i lartë i IFAC-ut ka raportuar për punën trevjeçare të kësaj organizate, kurse në sesionet në vazhdim, anëtarët e rregullt raportuan për zhvillimet e institucioneve që i menaxhojnë dhe zhvillimet e fundit për vendet, të cilat i përfaqësojnë në sektorin e teknologjisë. Po ashtu, në fund të punimeve u votua për zyrtarët e ri, të cilët do ta menaxhojnë IFAC për tri vitet e ardhshme, periudhën 2011 deri më 2014.

Në Kongresin XVIII të IFAC-ut, përfaqësuesi i UBT-së, Prof. Dr. Peter Kopacek, paraqiti një pasqyrë të plotë të projekteve të zhvilluara në UBT. Në fillim ai foli rreth konferencave shkencore të nivelit ndërkombëtar, që janë organizuar dhe mbajtur në UBT, por me theks të veçantë foli për konferencën “SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability” e cila u organizua dhe u mbajt në UBT, në Prishtinë, gjatë muajit tetor të vitit 2010 dhe konferencë e cila i mbodhi mbi 50 shkencëtarë ndërkombëtar.

Ai më pas cekti edhe Kampionatin e Robotëve që luajnë fut-

boll dhe ekipi “UBT-Kosova” e ka përfaqësuar vendin në mënyrë më shkencore. Kurse, për teknologjinë më moderne të arritur në rajon dhe botë, z. Kopacek tha se “falë UBT-së, Kosova është anëtarësuar edhe në dy organizma të nivelit botërorë si në OEC dhe IPMA”. Ai foli edhe për projektet e fituara nga Bashkimi Evropian, e në këtë rast vlen të theksohet projekti i “Erasmus Mundus” dhe që UBT për katër vitet e ardhshme do ta koordinojë këtë, po ashtu, ka paraqitur edhe “International Journal for business and technology” që ka fituar Numrin Serik Ndërkombëtar të Librit (ISSN) dhe ka filluar punën me sukses.

Kopacek i cekti edhe vizitat e vazhdueshme në SHBA dhe në Evropë, në kompani dhe universitete të ndryshme, të nënshkruar mbi 50 marrëveshje bashkëpunimi me universitete të rangut më të lartë nëpër botë, si dhe bëri një recapitullim të gjerë të zhvillimeve në Republikën e Kosovës.

Punimet e Kongresit pikërisht janë zhvilluar në Qendrën e Kongreseve “MiCo” në Milano, kurse ceremonia përmbyllëse e punimeve organizuar më 2 shtator në “Universita Cattolica del Sacro Cuore” po në Itali.

IFAC është organizatë e nivelit botëror në fushën e automatikës dhe inxhinierisë.

UBT në këtë organizatë është anëtar me të drejta të plota, e anëtarësuar që disa vite me votat e shumicës së vendeve anëtare.

UBT DHE REPUBLIKA ÇEKE PËR NJË AMBIENT ME SHUMË INVESTITORË

PRISHTINË, 01 QERSHORE 2011 – Në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Prishtinë, është organizuar konferenca ditore me temën “Përmirësimi i klimës së investimeve dhe ndërmarrësisë në Kosovë”.

Organizatorë dhe implementues të konferencës ishin Quality Kosova- Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) dhe Czech INVENT Technology Agency, kurse është mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Çekisë, SOROS-Zyra në Pragë dhe në Prishtinë dhe UBT.

Në konferencë u diskutua rreth mënyrës se thithjeve të investimeve të huaja direkte në Kosovë, si dhe u bë shkëmbimi i praktikave më të mira botërore për thithjen e këtyre investimeve.

Gjithashtu, në konferencë u diskutua edhe për krijimin, menaxhimin dhe praktikën më të mira të zonave ekonomike në rajon, Evropë dhe botë të cilat zona do të kontribuonin në zhvillimin ekonomik, zbutjen e papunësisë, shkëmbimin e teknologjisë dhe eksperiencave.

Pjesëmarrësve u janë përcjellur njohuritë dhe teknikat më të mira për nxitjen e investitorëve të huaj për të investuar në Republikën e Kosovës, ndërkohë që u është shpjeguar lidhja institucionale APIK-ut me Zyrat Rajonale të zhvillimit, në mënyrë që të



bëhet sa më mirë promovimi i klimës biznese në Kosovë, duke ju ofruar të dhëna dhe statistika të nevojshme, që do të ndikojnë në vendimin e biznesmenëve të huaj për të investuar në vendin tonë.

Gjithashtu, pjesëmarrësve u janë përcjellë praktikën më të mira të promovimit të shtetit të Kosovës në tregjet globale, të cilat eksperiencat do të ndikojnë në rritjen e numrit të investitorëve të huaj në Kosovë.

Pjesëmarrësit në konferencë ishin nga institucionet si: Quality Kosova- Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), Czech INVENT Technology Agency, AMNVM, AZHR - pesë zyrat rajonale, Banka Botërore, Asociacioni i Komunave, MPJ.

Vizitë nëpër komunat e Kosovës

Po ashtu, më 23 gusht 2011, në kuadër të këtij projekti për përmirësimin e klimës, janë organizuar vizita studimore nëpër komunat e Kosovës si në: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjiçan, Novobërdë, Shtime, etj., ku partnerët e projektit patën mundësi që për së afërmi t'i identifikojnë nevojat dhe kërkesat për përmirësimin e klimës së investimeve të huaja dhe patën mundësi të takohen edhe me Zyrat Rajonale Zhvillimore dhe me qeverisjet komunale.

Në fokus të vizitës kanë qenë komunat, të cilat disponojnë parqe industriale, zona ekonomike,

apo komuna të cilat planifikojnë që në të ardhmen të themelojnë parqe dhe zona.

Si vazhdimësi e projektit u organizua edhe një vizitë studimore në Pragë të Republikës Çeke.

Vizitë edhe në Republikën e Çekisë

“Quality Kosova” në bashkëpunim me “Czech INVENT”, nga 11 deri më 15 shtator, qëndruan për vizitë studimore në kryeqendrën e Republikës së Çekisë.

Interesimi i palëve pjesëmarrës në vizitë ishte që për së afërmi ta shohin zhvillimin lokal, zhvillimin e zonave ekonomike, të parqeve, bizneseve, për të bërë promovimin e in-

vestimeve të huaja në rajonet e Republikës së Kosovës tek investitorët potencial çek.

Përveç kryetarëve të Komunave të Kosovës nga delegacioni i vendit tonë janë edhe përfaqësues të Agjencionit për Promovimin e Investimeve në Kosovë, të Agjencionit për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme të Kosovës, të Agjencionit për Privatizimin e Kosovës, të Agjencionit Regjional për Zhvillim si dhe Universiteti për Biznes dhe Teknologji, gjegjësisht “Quality Kosova”.

Pas vizitës si pjesë finale e projektit do të organizohet edhe një konferencë, ku do të diskutohet rreth krijimit të strategjive për përmirësimin e klimës së ndërmarrësisë dhe investimeve të huaja në Kosovë.

Quality Kosova është themeluar dhe drejtohet nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) dhe e pranuar me të drejtë të plota si anëtare e Organizatës Evropiane për Cilësi (European Organization for Quality).

Quality Kosova funksionon që nga viti 2006 dhe është asociacion që merret me çështjen e kualitetit, standardeve, certifikimeve dhe konfirmimit. Promovon cilësinë në Kosovë, në bazë të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, merret me certifikimin e sistemeve e produkteve, si ISO 9001 e të tjerë.



LULZIM BEQIRI - VIZITË STUDIMORE NË RUMANI

PRISHTINË - 20 SHTATOR 2011 - z. Beqiri për disa ditë me radhë ka qëndruar për vizitë studimore në Universitetin e Bukureshtit, që është organizuar nga projekti Tempus dhe menaxhuar nga projekti Wus Austria - Zyra në Kosovë.

Vizitës në fjalë ju kanë bashkangjitur edhe dhjetë përfaqësues të institucione të arsimit të lartë privat në Kosovë, dhe më

konkretisht Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) e ka përfaqësuar Can. Dr. Lulzim Beqiri, njeherit ligjërues dhe menaxher për Departamentin e Sigurimit të cilësisë në UBT.

Vizita studimore ka të bëjë me menaxhimin e zyrës së cilësisë dhe me menaxhimin e cilësisë në kuadër të Universitetit, shkëmbimi i përvojave në fushën e arsimit në mes

të Kosovës dhe Rumanisë, dhe gjithashtu përfshin edhe menaxhimin në të gjitha lëmit universitare si hulumtime, projekte, menaxhment, intership, etj.

Një vizitë e tillë, po ashtu pesë ditorëshe gjatë muajit prill po të këtij viti është realizuar edhe në Kolegjin Universitar Kork (UCC), në Irlandë, dhe UBT-në e pat përfaqësuar z. Beqiri.

UBT NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMIN ME UNIVERSITETIN PARTHENOPE

23 nëntor - Presidenti i UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe rektori i Universitetit Parthenope, në Napoli të Republikës së Italisë, Prof. Claudio Quintano, zhvilluan një takim dhe nënshkruan marrëveshje bashkëpunim ndëruniversitar mes dy institucioneve.

Kjo marrëveshje parasheh mundësinë e bashkëpunim ndëruniversitar në të gjitha nivelet e studimit, sidomos në fushën e doktoratës.



UBT PËRFITUESE E SHUMË PROJEKTEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN

PRISHTINË, 20 KORRIK 2011- UBT prej themelimit në vazhdimësi është përfituese e projekteve ndërkombëtare të sektorit të arsimit në Evropë dhe më gjerë. Gjatë këtyre ditëve, UBT përfitoi projektin "SEECCEL- South East European Countries for Entrepreneurship Learning", projekt i Bashkimit Evropian.

UBT është Universiteti i vetëm privat nga Kosova që është përfituese e projektit në fjalë.

Përfituese të këtij projekti janë edhe disa shtete të rajonit dhe më gjerë si Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Shqipëria dhe Turqia.

Projekti në fjalë, përveç të tjerave, ka për qëllim të zhvillojë ndërmarrësinë në institucione jobiznesore, përmes institucioneve universitare, në mënyrë që studentët dhe stafi i këtyre institucioneve përfituese të aftësohen sa më shumë në perceptimin e

filozofisë që mbartë në vete ndërmarrësinë (ekonominë e orientuar dhe tregun).

Drejtoresha e projektit "SEECCEL", znj. Erika Heder, në takim me këshilltarët e lartë të Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë, tha se institucionet e përzgjedhura, në vazhdimësi për vitet në vijim kanë me qenë target nga fondet e shumta të programeve që ofron ky projekt përmes Komisionit Evropian dhe studentët e stafi i tyre do të ketë benefite të mëdha.



UBT BASHKËPUNON ME UNICEF-in

PRISHTINË, 19 GUSHT 2011 – Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë. Marrëveshja në fjalë u nënshkruar dhe palët mysafire u pritën në kabinetin Presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi në UBT.

Marrëveshja parasheh forcimin dhe aftësimin për kapacite-

tet e rinisë së Kosovës, për zgjidhjen e problematikave aktuale, si dhe aftësimin e të rinjve për të inicuar në biznese aktuale të nevojshme lokale për një të ardhme më të mirë dhe të sigurt në të gjitha fushat e jetës.

"Shumica e të rinjve të Kosovës janë ballafaquar me sfidat nga më të ndryshmet dhe ne si institucion e kemi parasysh që sot

na rrethon bota e teknologjisë më moderne dhe me mjet më të avancuara dhe për këtë ne si prioritet kemi që të angazhohen të rinjtë dhe t'u lejojnë atyre të shprehin talentin dhe krijimtarinë e tyre në mënyrë sa më konstruktive", tha zëvendëshefi i UNICEF-it me zyrë në Kosovë, Luciani Caestini.

Caestini tha se ne kemi filluar bashkëpunimin me UBT-në,

institucion universitar privat në Kosovë, dhe jemi të kënaqur me organizimin dhe punën që bëhet në këtë institucion si në zhvillimin e kërkimeve shkencore, me stafin akademik, me studentët aktualë dhe vazhdimisht në rritjen e tyre. Sipas tij, ky numër i studentëve të Universitetit do të jetë në gjendje të fitojë përvoja praktike dhe të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve në emër të një numri të institucioneve të Kosovës.

Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i falënderoi

mysafirët për kontributin e madh që Zyra e UNICEF-it e ka dhënë për shëndetin e nënave, fëmijëve dhe të rinjve në Kosovë dhe në parim mbështeti idenë për bashkëpunim që u nënshkrua nga dyja palët.

Bashkëpunimi institucional do të administrohet bashkërisht nga dyja institucionet si Zyra e UNICEF-it në Kosovë dhe Universitetin e UBT në Prishtinë dhe me partnerët e tjerë të biznesit.

ANKETE ME STUDENTË TË UBT –së:

SA JENI TË KËNAQUR ME AMBIENTIN QË NA RRETHON?



Leonita Orllati

Kosova është vendi më i ndotur në Evropë, me pluhur, mbeturina, mungesë gjelbërimit etj.



Roland Luka

Qyteti jonë është i mbuluar nga pluhuri, mbeturinat dhe nga mungesa e gjelbërimit. Prandaj vlerësoj se organet kompetente së bashku edhe me qytetarët duhet të bëjnë më shumë për një ambient të pastër.



Blin Bakii

Ka shumë parregullsi që e karakterizojnë ambientin tonë, së pari pastërtia nuk është në nivel, mbeturinat dhe mungesa parqeve dhe problemi më i madh është se popullatë duhet të vetëdijësohet më shumë në këtë drejtim për një vend më të pastër në rrethin ku po jeton, se pa vetëdijësimin e saj nuk mundem me ba ambient siç dëshirojmë ne për vete dhe vendin tonë.



Flojera Thaqi

Kompanitë të cilat e kanë për detyrë të mbikëqyrin hapësirat e caktuara, siç po shihet nuk po kryejnë obligimet dhe detyrat ashtu siç duhet, sepse nuk mund me ndodh kjo papastëriti aq e madhe që po na rrethon.

Anketoi: Berna Devexhiu, studente në UBT

SI E KENI MBYLLUR NJË VIT AKADEMIK NË UBT?



Hana Jahiu

Gjatë tërë vitit akademik kemi pas një orar të ngjeshur të ligjëratave, ushtrimeve, konferenca ve, debateve etj, por mundem me thënë se ka qenë një vit i suksesit në aspektin studimor dhe profesional, po ashtu vlen të theksohet se brenda këtij viti përveç studimeve jam angazhuar edhe si staf i UBT-së, dhe me këtë ndihëm e privilegjuar që jam pjesë e këtij universiteti.



Agron Sverkaj

Gjate periudhës një vjeçare të studimeve të mija në UBT ka qenë një epokë e re sa i përket zgjerimit të njohurive në teknologji. Të studiosh në UBT do të thotë që je karshi vendeve evropiane si dhe në raport me universitetet tjera unë e ndijë vetën të privilegjuar që jam student i UBT-së. I dëshiroj universitetit dhe studentëve që në të ardhmen te ketë suksese në fushat e ndryshme.



Drilon Zenuni

Në UBT organizohen konferenca dhe aktivitete të shumta shkencore e debate me personalitete të kompanive gigante të vendit dhe ndërkombëtare etj, dhe kur ke qasje në këto aktivitete që i cekëm më lartë patjetër edhe suksesi është i garantuar, po ashtu në UBT ka afërsi të madhe mes profesorëve dhe studentëve.



Nderim Mehmeti

Lirshëm mundem me thënë se kemi kaluar një vit të suksesshëm akademik në UBT. Ligjërata dhe ushtrimet janë organizuar rregullisht, profesorët e kanë dhënë maksimumin për ne, disiplina ka qenë në nivel të mirë etj, dhe marrë në përgjithësi kemi kaluar një vit të suksesshëm.

ANKETË ME STUDENTËT E UBT-SË

SI VENDOSËT TË STUDIOINI NË FAKULTETIN SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI NË UBT?

UBT është përfituese e projektit "Erasmus Mundus", dhe përmes këtij projekti studentët e UBT-së mund të studiojnë në 16 universitete në vendeve të BE-së, gjithashtu UBT ofron kushte dhe mësim cilësor, ofron praktikën mësimore nëpër institucione brenda dhe jashtë vendit, ka një numër të madh të marrëveshje ndëruniversitare në botë për shkëmbimin e stafit dhe të studentëve, shumica e të diplomuarve në UBT sot janë të punësuar nëpër kompani më të mëdha në vend dhe jashtë vendit, dhe në institucione shtetërore etj. Këto ishin arsyet dhe qëllimet e të anketuarve tanë si dhe pse kanë vendosë të studiojnë në UBT.



Kastriot Qorrolli

Nga ky vit i ri akademik 2011-2012 po edhe në vitet në vazhdim studentët e UBT-së mund të vazhdojnë studimet universitare në universitetin City në Londër, më të njëjtën shumë dhe pagesë dhe u interesova për më shumë dhe e pash të udhës që përmes UBT mundem me lëvizë edhe jashtë Kosovës dhe vendosa ta zgjedhi UBT-në. Por desha të shtoj edhe diçka se siç e kam vërejtur vullneti i menaxhmentit të UBT-së dhe stafit akademik është për të na bërë neve sa më profesional në lëmi që po studiojmë, dhe mendoj se pas përfundimit të studimeve në do të dal një inxhinier i kërkueshëm në tregun e punës.



Albiona Ismaili

Të gjithë dëshirojmë një studim sa më të mirë dhe më cilësor për formimin e personalitetit tonë, dhe duke e parë që UBT është universiteti më i miri privatë në vend, vendosa të studioj në universitetin në fjalë, në Fakultetin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri. Po ashtu UBT është përfituese e projektit "Erasmus Mundus", ku përmes këtij projekti studentët e UBT mund ti vazhdojnë studimet në 16 universitete më prestigjioz të vendeve të Bashkimit Evropian dhe me këtë po bindem çdo ditë e më shumë se me të vërtetë kam bërë zgjidhje pozitive.



Blerina Gashi

Në këtë universitet janë kushtet e mira për studime dhe stafi akademik është i nivelit më të lartë që ka ndonjë universitet në vendin tonë. Është fakultet me ambicie shumë të mëdha për ardhmen tonë. Unë si student dua të fitoi gjithçka që është e mundur në profesionin tim nga ky fakultet që ti ndihmojë shoqërisë tim në të ardhmen. Mendoj në të ardhmen të bëhem një inxhinier profesional, dhe UBT do mburret me kuadrin që ka shkolluar deri më tani.



Petrit Zekiqi

Para se të vendosi të regjistrohem në fakultet kam shikuar të gjitha ofertat që ofrojnë universitete private dhe në ofertën e UBT-së kam hasë shumë ngjashmëri me universitete që janë më famë botërore. Fakultetin Shkenca Kompjuterike e zgjedha këtë drejtim sepse arsyet ishin të mjaftueshme, pasi që kisha një lloj prirje për të dhe mundësia e përhapjes së këtij profesioni çdo ditë e më shumë në vendin tonë. Mbetem me shpresë që do të kem një të ardhme të ndritur.



Lerat Rudi

Të gjithë studentët të cilët kanë përfunduar studimet në UBT janë sot të punësuar nëpër kompani të mëdha në vend dhe jashtë vendit, po ashtu ata të cilët kanë dashur të vazhdojnë studimet jashtë vendit janë pranuar pa problem dhe sidomos nëpër universitete më të forta të botës. Dhe mendoj se pas përfundimit të studimeve themelore edhe unë do ta ndjek rrugën e tyre ose në punësim ose vazhdimin e studimeve jashtë vendit përmes UBT-së.

Anketoi: Leonita Orllati, studente në UBT, viti I-rë

6 METODA SIT'I LARGOHESH PIRJES SË DUHANIT

Tash të gjithë i dimë pasojat e duhanit dhe nuk na duhet të pyesim mjekun për të dhe se e dëmton shëndetin. Gjithashtu gjithë e dimë që është e vështirë ta lëmë duhanin dhe se nuk ka ndonjë bar magjik që ta mundësojë këtë. Sidoqoftë ka disa mjete dhe trika që mund të ju ndihmojnë duhanpirësve ta tejkalojnë dëshirën e zjarrtë dhe vazhdosh tutje pa ndez cigaren. Poshtë do të gjeni gjashtë metoda nga më të mirat dhe shpresoj se do i praktikoni që duhani më të mos jetë pjesë e jetës tuaj.

1. Mentoll – Shija e mentollit apo pepermintit e bënë gojën e duhanpirësit të ndihet e freskët dhe e pastër, e kjo e mashtron trurin dhe e bënë të ndjenë me pak dëshirën për të ndezur cigaren. Vendos mentoll gjithandej kështu që i ke afër sa herë që të nevojiten. Merr me vete, lëri në veturë, mbushi xhepat dhe gjithkund nëpër shtëpi.

2. Pi ujë. Për të kaluar dëshirën për ta ndez cigaren dhe në të njëjt-

tën kohë për të forcuar qëllimin pozitiv për të qenë më i shëndetshëm, një trik i mirë është që të pish një gotë ujë shumë ngadalë kur goditeni nga dëshira për ta ndez. Gjersa pini ujin imagjino sikur uji po ju largon dëshirën si dhe shpërlan duke nxjerr jashtë të gjitha materiet toksike të duhanit. Suan Gayle, një konsulente e fiksimeve si dhe autore e CD shumë të popullarizuar "stop-smoking", tregon se dëshira e zjarrtë për ta ndez cigaren zgjat vetëm 15 sekonda. Kështu me pirjen e ujit ju e shpërqendroni vetveten dhe dëshira për ta ndez largohet.

3. Çamçakëz – kjo mund të duket e qartë, por ekspertët thonë se ka një arsye që ata e rekomandojnë çamçakëzin – vërtet funksionon. Shija e çamçakëzit e mban gojën e freskët, kështu duke e bërë pirjen e duhanit më pak atraktive. Vet akti i përtpjes çliron dëshirën për stimulim oral dhe në të njëjtën kohë e mbanë gojën të nxënë. Shpesh duhanpirësit zgjedhin çamçakëz me nikotinë por shumë ekspertë

që ndihmojnë për ta lënë duhanin thonë se çamçakëzi pa sheqer dhe me shije mint funksionon njëjtë e ndoshta edhe më mirë.

4. Ha rrush të kuq ose vjollcë – të hash rrush jo vetëm që është një teknik për stimulim oral por gjithashtu kimikalet natyrale dhe antioksiduesit në rrush punojnë për të ju çliruar nga dëshira për ta ndez cigaren, thotë ekspertja Susan Gayle.

5. Përdor kalendarin – Njeriut i duhen 21 ditë që një lloj mendimi të bëhet proces automatik, diçka që kërkohet për të eliminuar vesin e pirjes së duhanit, thonë ekspertët. Tre javë pa pirë duhan mjaftojnë që kjo veti e mirë të ngulitet në

mendje. Por ashtu sikur cilido duhanpirës apo pijanec mund të ta thotë se ato pak ditë e para janë më të vështirat. Pas atyre ditëve, dëshira zvogëlohet dhe intervali i shfaqjes së kërkesës për ta ndez cigaren zgjatet kështu duke ju ofruar duhanpirësve më shumë kohë të ndjesisë së mirë. Vendos një kalendar aty ku një duhanpirës në shtëpi në tuaj mund ta shoh dhe shëno çdo ditë që



ai/ajo ka kaluar pa pirë duhan. Shpërbleje në fund të javës së parë dhe të dytë me diçka që ai/ajo vërtetë e dëshiron, po që se mundesh edhe iPad ble për të! Në fund të javës së tretë bëj diçka të rëndësishme për ta përkujtuar rastin, si për shembull qite në drek apo përgatit diçka speciale për të.

6. Përdor çamçakëz nikotine – jo të gjithë ekspertët pajtohen në dobitë e zëvendësuesve të nikotines (cigares) që ndryshe e quajnë terapi e zëvendësimit të nikotines pasi që nuk e thyjnë fiksimin fizik ndaj duhanit. Sidoqoftë ato mund të jenë të dobishme në tejkalimin e fiksimit psikologjik ndaj duhanit, që është pjesë e rëndësishme e gjithë kësaj pune. Prapëseprapë ekspertët sugjerojnë se arnat (patch) apo çamçakëzi duhet të përdoren vetëm në kombinim me konsultim apo përkrahje grupore sepse nuk ka shumë gjasa që të funksionojnë vetvetiu.

Përgatiti Nasuf Isufi, UBT, viti II –të

LIGJËRUESIT E UBT-së PUBLIKOJNË ARTIKUJ SHKENCORË NË REVISTA NDËRKOMBËTARE



Nazmi Zeqiri

Nazmi Zeqiri, ligjërues në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), ditë më parë ka publikuar një artikull në revistën e njohur shkencore "International Journal of Advanced Economics and Business Management", ISSN: 2230-7826. Në këtë artikull autori ka trajtuar për rëndësinë dhe ndikimin e investimeve të huaja direkte.

Më konkretisht artikull në fjalë ka të bëjë me shqyrtimin dhe ndikimin e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në vendet në tranzicion. Më konkretisht autori është bazuar si në shqyrtimin e literaturës dhe në studimet e fundit empirike nga fusha e investimeve të huaja, me fokus të veçantë në ndikimin e IHD në zhvillim ekonomik, punësimin dhe pagat, produktivitetin, transferimin e teknologjisë dhe rrjetëzimin e ndërmarrjeve.

Artikulli është shkruar dhe botuar në gjuhën angleze. Në këtë artikull Nazmi Zeqiri et al, konstaton se Investimet e Huaja Direkte (IHD) në shtetet në tranzicion kanë një histori të shkurtë mirëpo me fuqi mbresëlënëse dhe se IHD me të drejtë shihen si një nevojë e pakontestuar për zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve në tranzicion. Sipas Tij, edhe

pse literatura rreth ndikimeve të IHD është e madhe, rezultatet nga studimet e ndryshme lidhur me ndikimin e IHD-ve në ekonomi janë jo të pajtueshme dhe specifike për vendet e caktuara. Megjithatë sipas literaturës dhe hulumtimeve të autorit mund të konkludohet se sa ju përket shteteve në tranzicion, ka më shumë pajtueshmëri për efektet (pozitive) sidomos në disa vende që kanë tranzicion te avancuar.

Në këtë artikull, autori nuk haron të potencojë gjithashtu edhe shkaqet dhe arsyet e shumta pse vendet në tranzicion dëshirojnë të thithin sa më tepër investime të huaja. Sipas tij, për shkak të tranzicionit (të shpejtë dhe sfidues) nga ekonomia e planifikuar (komuniste) tek ajo e tregut, në shumicën e shteteve në tranzicion, kapitali vendor është i paaftë të përmbush të gjitha

nevojat për investime. Prandaj, roli dhe ndikimi i IHD paraqitet si i rëndësishëm në ekonominë në tranzicion në krahasim me vendet e zhvilluara. Në përgjithësi autori pajtohet se jo të gjithë ekonomistët bien dakord mbi efektet pozitive dhe ndikimit të IHD, por kur është fjala për ekonominë e pazhvilluara e sidomos ato në tranzicion, sipas literaturës ekonomike atëherë ka më pak polemika dhe të gjithë pajtohen për efektet pozitive të IHD në zhvillimin ekonomik.

Në konkludimet e artikullit, Nazmi Zeqiri et al thekson se vlerësimi i përgjithshëm i ndikimit të IHD në vendet në tranzicion, për shkak të efekteve të tija dhe për shkak të rritjes së tendencave në disa vende të avancuara në tranzicion tregon se IHD mund të luaj rol kyç në zhvillim. Megjithatë autori venë në pah

se ndikimi i IHD-FDI varet nga shtetet mikpritëse dhe mundësinë e absorbimit, prandaj autori nuk heziton të tregoj edhe rëndësinë e kompetencave vendore në garën që të jenë sa më atraktive për investitorët e huaj.

Për këtë artikull autori ka shfrytëzuar një mori hulumtimeve të bëra për investimet e huaja në vitet e fundit dhe një numër të madh të artikujve shkencor të njohur nga kjo fushë. Artikulli në fjalë është mirëpritur si në aspektin e studuesve të kësaj fushe por edhe për tiparet akademike që posedon.

Ky është publikimi i tretë për Nazmi Zeqiri nëpër revistat e njohura ndërkombëtare. Së fundmi, ai gjithashtu është duke u përgatitur edhe për publikimin e radhës që për tematik të studimit ka Buri met e Ndryshimeve në Sektorin e Telekomunikimit.

MODELIMI DHE SIMULIMI I AUTOMJETIT



Ahmet Shala

Bazuar në natyrën multi-disiplinare dhe komplekse të sistemit të automjeteve, dizajnimin dhe zhvillimin e sistemit të automjetit kryesisht varet nga teknologjitë e fundit dhe relativisht varet nga koha e shpenzuar dhe kostoja. Në këtë punim është përshkruar dizajnimin, zhvillimin dhe simulimin e një modeli të përgjithshëm, me përdorim të Matlab/Simulink. Secili modul është i shoqëruar me një bllok të Simulink-ut i cili përmban modele matematikore dhe veti fizike. CAD modeli që është krijuar me përdorim të Autodesk 3ds Max është ekstraktuar në VRML format dhe edituar përmes V-Realm Builder 2.0 përpara se të bartet në Matlab/Simulink përmes vegëltore Virtual Reality.

Qëllimi i këtij punimi është modelimi dhe simulimi i sistemit të automjetit. Zhvillimi i sistemit të automjetit është shumë i komplikuar dhe kërkon njohuri nga shumë fusha, siç janë: dizajnimin e makinave, zhvillimin e elektronikës dhe rregullimin e sistemit. Këto projekte marrin kohë dhe kosto për zhvillim. Për këtë arsye, një platformë simulimi të një sistemi gjithëpërfshirës është zgjidhje efektive për hulumtim dhe zh-

villim. Këtu është realizuar modelimi dhe simulimi i një modeli gjithëpërfshirës të automjetit me përdorim të platformë për simulime Matlab/Simulink. Ideja është të dizajnohet dhe zhvillohet një platformë e përgjithshme simulimi që të lehtësoj dizajnimin e rregullatorëve dhe konfigurimet harduerike.


Rezultatet e fituara nga simulimi janë paraqitur përmes 3D modelimit në mjedisin virtual real për vizualizim më efektiv. Përveç kësaj, realiteti virtual ofron një mënyrë të re të simulimit të sensorëve të integruar në një mjedis të përbashkët. Për të ardhmen në këtë drejtim, përmes këtij punimi kemi hapur rrugën për zhvillimin e grup-moduleve standarde dhe integrimin e tyre në dizajnimin e sistemeve të reja.

Kapaciteti llogaritës i Matlab-Simulink është avantazh për të hulumtuar teknika të reja kinematike ndërsa analiza dhe

simulimi vazhdojnë me teknikat e deritashme. Rregullatori Fuzzy Logjik (FLC), i llojit Sugeno është përdorur për rregullim dhe simulim të modelit të automjetit gjatë parkimit të tij në vend-parkim.

Si fazë e parë e projektit për zhvillim dhe simulim të sistemit gjithëpërfshirës të automjetit përmes këtij punimi është arritur të realizohet modeli bazik për simulim i cili do të përdoret në hulumtimet tona në të ardhmen.

Hap tjetër do të jetë modulimi i komponentëve që të ofrohet modelim fleksibël për parametra të ndryshëm. Element tjetër do të jetë algoritmi i rregullimit të sistemit të automjetit. Por përpara kësaj, sistemi i lidhjeve kthyesë në mjedisin real virtual duhet të mundësohet. Mjedisin interaktiv është i nevojshëm për simulim të sistemit të rregullimit. Me arritjen e këtyre qëllimeve ky do të jetë një paket komplet për simulim të sistemit të automjetit.



Rregullatori Fuzzy Logjik, lloji Sugeno.

Tekst i cekur më lartë është përmbledhje e punimit shkencor që autori së bashku me bashkautorët Edmond Hajrizi – Presidenti i UBT-së dhe Ramë Likaj – profesor në UP / FIM, e kanë prezantuar në konferencën shkencore "SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability"; të mbajtur në Prishtinë, në UBT, gjatë muajit Nëntor 2010.

HULUMTIMI "BESUESHMËRIA MES KONSUMATORIT DHE PRODHUESIT"



31 tetor - "Besueshmëria mes konsumatorit dhe prodhuesit" ishte tema e hulumtimit të Presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, të paraqitur në konferencën "Standardet dizajnojnë të ardhmen", të organizuar nga Agjencia e Standardizimit - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Në hulumtimin "Besueshmëria mes konsumatorit dhe prodhuesit", realizuar nga organizata Quality Kosova (QK), e udhëhequr nga dr.Hajrizi, kryesisht është analizuar perceptimi i produkteve kosovare për cilësi, domethënë çka dhe si mendojmë në Kosovë për cilësinë e produktit.

"Në bazë të hulumtimit, kemi një raport jo të pëlqyeshëm mes eksportit dhe importit, do të thotë ka një import shumë të madh dhe një prodhimtarë ngadalë në rritje dhe rezultatet dalin se ne nuk besojmë në prodhimet dhe cilësinë e prodhimeve vendore pa qenë i kontrolluar", tha Presidenti i UBT-së, duke paraqitur hulumtimin.

Dr. Hajrizi tha se UBT e ofron brendin e vet "Quality Kosova", që merret kryesisht me vlerësimin e cilësisë së produktit kosovare.

REKUIEM BEGOLLIAN NË GJASHTË PAMJE

JETON NEZIRAJ

Pamja e parë – Kukulla plastike

Pak kohë mbas vdekjes së Faruk Begollit u mbyll edhe kafe-restoranti "Escargot", në qendrës të Prishtinës, në të cilin, gjatë dy viteve të dundit të jetës së tij, ai e ka kaluar pjesën më të madhe të kohës. Ka pasur tavolinën e tij të preferuar, aty afër dritares dhe, kur ajo tavolinë ishte e nxënë, shumë vështirë vendoste të ulej në tavolinën tjetër. Në krejt këtë, nuk kishte thujta asgjë të pazakonshme: thjesht, rrinte, pinte kafe, lexonte gazeta dhe mandej, si zakonisht, pinte edhe raki. Pinte me ish studentët dhe me shokët e pakët, e ndonjëherë nuk ekziston, është kthyer në dicka tjetër, në një butik të zakonshëm, nga ata që tashmë Prishtina i ka me bollëk. Në vendin ku më parë ka qenë tavolina ku rrinte Begolli tash është vënë një kukull plastike, si të gjitha kukullat "modeliste", me fytyrë të buzëqeshur. Nuk e di pse ende vazhdoj të gjej njëfarë pikëtakimi simbolik midis kohës kur aty, në një atmosferë plot jetë e gjallëri, me rruftje kafesh, muhabete të gjata e shaka, dhe kohës së tashme, mbas vdekjes së Begollit, kur në vendin e tij qëndron kukulla e pajetë me buzëqeshjen e saj "plastike". Pavarësisht nga kjo, një gjë tashmë dihet: Prishtina nuk është më ajo që ka qenë me Begollin. Ka një ndryshim thelbësor në shpirtin dhe në zemrën e saj si kryeqytet. Një ndryshim si ai në kafenenë tashmë të shndërruar në butik. E ne, më duket me pak vonësë, po e kuptojmë se e tashmë e kemi humbur një njeri të mrekullueshëm, një artist të jashtëzakonshëm dhe një profesor të pashoq.

Pamja e dytë – Librat dhe fletoret e Begollit

Begolli ishte i sëmurë rëndë. Unë, ndërkaq, po punoja për përgatitjen e monografisë së tij. Një nga prej momentet më prekëse të atyre ditëve, ishte ai kur e luti të motrën të na i sillte kofert dhe cantat, në të cilat i kishte librat, fletoret, ato pak copëza gazetash dhe tek tuk ndonjë foto. Na tha se mund t'i merrnim krejt ato që na hynin në punë. Nisëm të shkapurisim dhe t'i ndajmë mënjanë materialet që na duheshin. E mora e Begollit, Aslihaja, e cila që prej shumë vitesh, e sidomos në ditët e dergjës së tij, përkujdesej për të vëllain, na shikonte me pikëllim. Ashiqare, i copëtohej zemra që po i merrnim gjërat personale të Farukut. Edhe pse Begolli ishte ende gjallë, ne po shkapurisim si mbi gjësendet e mbetura të një të vdekuri. Kot përpiqeshim ta tejkalonim me "shaka" atë atmosferë të rënduar. Gjithçka

në ato çaste ziente nga pikëllimi. Vetëm lotët ishin mangut. Ndërkohë, Begolli na tha që t'i merrnim me vete edhe shumicën e librave, sepse, siç u shpreh, nuk i po i duheshin më për asgjë. Ne, megjithatë, e pyesnim: "Ta marrim, apo ta lëmë këtë libër?" E përgjigja e tij, si zakonisht, ishte: "Merreni, more, e mos bani hajgare". Për të ky ishte momenti i duhur i "djegies së librave pa vlerë". Morëm shumicën e librave dhe lamë fare pak. Mbetën vetëm disa nga ato, për të cilat ai mendonte se mund t'i duheshin më tutje në punën e tij me studentët.

Pamja e tretë – Të pathënat

Kanë mbetur pa u thënë për Faruk Begollin edhe shumë gjëra të tjera të rëndësishme. Shumë nga këto, sidomos nga jeta e tij private, ai do t'i ketë marrë me vete në botën e përtejme. Në përgjithësi, Begolli nuk ka folur për jetën e tij private dhe nuk ka dashur të flasë shumë as për kohën e jetës së tij në Beograd. Madje, sa për kuriozitet, kaptinën e monografisë, në të cilën flas për martesën dhe jetën më ish gruan e tij, Zoja Begollin, e kam shkruar duke u mbështetur në rrëfimet e të tjerëve mbi këtë çështje dhe në ato pak informacione që kam mbledhur nga gazetatat e hershme. Pak para se të botohej monografia e tij, e thirra në telefon dhe i tregova se në të kisha shkruar edhe për ish bashkëshorten e tij. E pyeta nëse mund ta botoja librin për të bashkë me këtë pjesë ku bëhej fjalë, jo veç për artin, por edhe për privatësinë e tij. Përgjigja e tij ishte: "Në rregull, mund ta botosh, por le të jetë bukur". Me këtë më bëri të kuptoj atë që tashmë e kishte thënë edhe shumë herë të tjera nëpër intervista të ndryshme: ai për ish gruan e tij ndjente shumë respekt dhe në asnjë mënyrë nuk do të lejonte portretimin e saj të "shtrembër".

Pamja e katërt – Kur vdesin artistët, armët e urrejtjes heshtin

Për vdekjen e Faruk Begollit kanë raportuar pothuaj të gjitha mediat në hapësirën e krejt ish Jugosllavisë e, gjithashtu, edhe disa media të rëndësishme ndërkombëtare. Rralë mund të gjindet ndonjë personalitet tjetër si Begolli, për të cilin, pas luftërave të përgjakshme midis kombeve të ndryshme në ish Jugosllavi, të gjitha mediat, serbe, kroate, sllovene, shqiptare, boshnjake, malaziasie e maqedone, kishin shkruar dhe vlerësuar se vdekja e tij ishte "një humbje e madhe". Reagimet e shtypit dhe të ish bashkëpunëtorëve të tij në Beograd ishin tejet prekëse. Dhe, pas krejt atij hendeku urrejtjeje që ka shkaktuar lufta midis njerëzve të kombeve të ndryshme, nuk ke se si të mos habitesh kur dëgjon dhe sheh se sa njerëzishëm dhe



sa sinqerisht flitet dhe shkruhet për një njeri dhe artist të madh si Faruk Begolli. Njerëzit dhe artistët si ai, me përmasat e tyre të jashtëzakonshme, kapërcejnë mbi urrejtjen dhe patologjinë nacional-shoviniste primitive. Ata, jo veç me jetën, por edhe me vdekjen e tyre, përçojnë midis njerëzve mesazhe paqeje, mirëkuptimi, dhembjeje të përbashkët, dashurie e miqësie. Kur vdesin njerëzit si Faruk Begolli, gjuha e urrejtjes dhe armët, të paktën për një çast, heshtin.

Pamja e pestë – Mirënjohjet në kohën e lëngatës

Gjatë kohës sa ishte i sëmurë, Faruk Begolli mori disa shpërblime dhe mirënjohje. Kushedi, çmime të ndryshme mund t'i jepen atij edhe tash pas vdekjes. Presidenti i Kosovës apo Ministria e Kulturës mund t'ia akordojnë titullin "Artist i Merituar" post mortum apo t'ia ndajnë shpërblimin për "vepër jetësore". "Edhe këta të ujësjellësit 'Batllava' një ditë do të ma japin ndonjë shpërblim për pagesën e rregullt të ujit", u shpreh me ironi e humor të zi Begolli kur e njoftuan se dikush e kishte nderuar me një mirënjohje tash kur sëmundja e kishte ngujuar për shtrati. "E, kur të vdisni, të gjithë, televizionet, radiot, teatrot, institucionet kulturore dhe ato shtetërore, ju lavdërojnë, por jo më gjatë se një apo dy ditë. Kjo ngjan kur dikush vdes, ndërsa në të gjallë, nuk e di se pse, por nuk ju duan fare, madje as nuk ju inkurajojnë për të qëndruar dhe për të vazhduar më tutje me punën tuaj", kishte deklaruar Faruk Begolli, i harruar krejtësisht nga institucionet shtetërore, në një intervistë radiofonike në 60 vjetorin e lindjes së tij. Harresë e (pa)qëllimshme? Kushedi, sepse politikanët tanë kanë punë shumë të rëndësishme. Prerja e një shiriti në një rrugë prej dy kilometrash të shtruar me zhavorr për ta mund të ishte më me vlerë se

sa urimi apo pritja e një artisti në ditëlindjen e tij. E Faruk Begolli ishte më shumë se veç një artist. Ai ishte ylli i filmit i adhuruar nga miliona e miliona njerëz jo veç në Kosovë, por në krejt ish Jugosllavinë. Në vitet e arta të karrierës së tij, e kishte braktisur Beogradin, vendin ku ishte krijuar nami dhe kulti i tij dhe, duke mos e kthyer më kokën prapa, ishte kthyer përfundimisht në Prishtinë. Aty, midis njerëzve të gjuhës e të gjakut të tij, me thjeshtësinë dhe pragmatizmin e një artisti dhe njeriu të madh, ai kishte punuar për edukimin artistik të njerëzve të rinj. Nga një vend me gjerata aktorësh në plakje e sipër, ai e kishte mbushur Kosovën me ushtrinë e aktorëve të rinj.

Pamja e gjashtë – Shumë zhurmë mbas një varrimi të heshtur

Varrimi, me kërkesën e tij sa ishte gjallë, u bë në heshtje nga jo më shumë se 50 veta, kryesisht familjarë, kolegë dhe bashkëpunëtorë të tij të ngushtë. Mbas ceremonisë së varrimit, një grup i vogël njerëzish u kthyen në shtëpinë ku kishte jetuar Begolli dhe pinë nga një gotë raki për shpirtin e tij. Edhe kjo ishte pjesë e amanetit të tij. Të nesërmen e vdekjes së Begollit, një nga libraritë e kryeqytetit kërkonte me urgjencë disa kopje të monografisë së tij të sapobotuar. Mbledhja komemorativë u mbajt me disa fjalime dhe pa recitale patetike. Fjalimet e sidomos "recitale" në raste përkujtime ai nuk i kishte në qejf. Teatri "Dodona" hapi të "pame" (çfarë rituali i çuditshëm) dhe njerëzit vinin e u shprehnin ngushëllime atyre që ndodheshin aty: bashkëpunëtorëve të Begollit dhe punonjësve të teatrit. U organizua edhe një e ashtuqajtur "Nata e Begollit" me muzikë të gjallë dhe raki. Televizionet tona nuk rreshtnin së ri-transmetuari emisionet që vec i kishin shfaqur më herët për Begollin. Ndërkaq, Radio Televizioni i Kosovës e bëri "bozë" një xhirim të manifestimit në të cilin ishte bërë promovimi i monografisë për Faruk Begollin. Disa muaj më vonë, një festival filmik dhe teatror studentor iu kushtua tërësisht atij. Studentët veshën fanela me foton e Begollit dhe me mbishkrimin "Shpirtin ma keni këputë". Foto të Begollit me këtë mbishkrim mbuluan krejt Prishtinën. Poashtu, u shfaqën sërish filmat ku ka luajtur Begolli, ndërkohë që televizionet sërish i reprizuan emisionet e mëparshme për të. "Ej bre, po ju nuk të leni as me dekë", thoshte Begolli gjatë ditëve të lëngatës së tij në shtrat. Tash kur mbi varrin e Faruk Begollit ka mbi bari, ai, mbase, siç thoshte kur ishte gjallë, po e vazhdon lojën e tij në teatrin e botës së përtejme. "Atje po shkoj", thoshte ai, "për ta bërë një teatër më të mirë".

(Loja)

STUDENTJA E UBT-së KA PËRFAQËSUAR KOSOVËN NË SEMINARIN 'GOBI 2011'

Luljeta Shaqiri, studente në UBT, ditë më parë e ka përfaqësuar Kosovën në seminarin 'GOBI 2011' – Global Opportunities in Business and Investment, që organizohet nga Universiteti Teknologjik i Stambollit (ITU), në Stamboll të Turqisë.

Po ashtu, në këtë seminar morën pjesë rreth 50 studentë nga vendet e ndryshme të botës si nga Kosova, Franca, Italia, Kroacia, Rusia, Finlanda, Çekia etj. Gjithashtu, kanë marrë pjesë edhe 12 kompanitë më të suksesshme dhe menaxherë të kompanive të njohura nga e gjithë bota.

Ky organizim ka pasur për qëllim të ofrojë pesë ditë të mrekullueshme për pjesëmarrësit nga vende dhe institucionet e cekura më lartë dhe për studente që



studiojnë në lëmi të biznesit, ekonomisë, financave dhe nga lëmi shoqërore.

"Kisha kënaqësinë dhe nderin ta përfaqësoja Kosovën, përkatësisht UBT-në në GOBI 2011", tha znj. Shaqiri.

Këmbimi i ideve, njoftimi me studentë të ndryshëm nga e gjithë bota, prezantimi i kulturave të ndryshme, ligjëratat nga profesorët më të mire të Turqisë, znj. Shaqiri i kanë lënë përshstypje pozitive.

HAJRIZI: SEKTORI PRIVAT VLERËSOHET SHUMË NGA INVESTITORËT E HUAJ

Prishtinë, 31 tetor 2011- Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në Prishtinë, si pjesë finale të projektit për përmirësimin e klimës së ndërmarrësisë dhe investimeve të huaja direkte në Kosovë, në hollin e objektit të Hotelit Grand në Prishtinë, organizoi konferencën e radhës më saktësisht me temën "KOSOVA – GO International- Ngritja e Kapaciteteve për Investimet e Huaja Direkte", në bashkëpunim me Czech INVENT Technology Agency nga Republika Çeke dhe Kosova Association for Quality –Management, Certification and Confirmation- Quality Kosova.

Organizatorë dhe implementues të konferencës janë dy institucionet e cekura më lartë, si Quality Kosova- Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) dhe Czech INVENT Technology Agency, kurse është mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Çekisë, SOROS-Zyra në Pragë dhe në Prishtinë dhe UBT.

Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi pasi përshëndeti punimet dhe të pranishmit e konferencës në fjalë tha se gjatë hulumtimeve të bëra është parë se investitorët e jashtëm sektorin privat e vlerësojnë si shumë të rëndësishëm për investime. Ai tha se duhet krijuar kushte për këto investime, sepse është një prej sektorëve që ndihmon në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në vend.

"Sektori privat vlerësohet shumë nga investitorët e huaj si një sektor me një perspektivë të

madhe në zhvillim dhe kjo është e rëndësishme. Natyrisht mendohet edhe aspekti ekonomik dhe stabiliteti politik janë ata që ndikojnë në ngritjen e zhvillimit në përgjithësi", ka thënë ai.

Hajrizi ka shtuar më tej se e keqja është se investitorët e huaj nuk e dinë se ka ligj për investimet e huaja në Kosovë, dhe sipas tij, kjo tregon se ka mungesë të informacionit rreth legjislacionit aktual në Kosovë.

Përfaqësuesi i kompanisë Çeke "Czech Invent", Robert Hejzak thotë se nuk janë vetëm pengesat administrative ato të cilat pengojnë investitorët nga jashtë për bërjen e biznesit të tyre, por janë edhe konfliktet apo armiqësitë e institucioneve qendrore apo edhe të atyre lokale ndaj investimeve të huaja.

"Në disa prej institucioneve, qofshin qendrore apo lokale ekziston një lloj armiqësie ndaj investimeve direkte nga jashtë. Thonë po i duam investimet direkte nga jashtë, por nuk duam që kompanitë tona të humbin punët e tyre, vendet e punës, biznesin, tregjet e punës, domethënë është një lloj armiqësie ndaj këtyre investimeve direkte", ka thënë ai.

Sipas tij, organet kompetente duhet që përmes kornizës ligjore t'i sigurojë investimet nga jashtë dhe mandej t'i mbrojnë këto investime direkte.

Më tej, ai shton se nëse korniza ligjore nuk është aq e mirë sa e



vendeve në rajon për krijimin e lehtësira për investime direkte dhe bërjen e biznesit në Kosovë, atëherë investitorët nuk do të vijnë në Kosovë, por do të shkojnë në vendet tjera, të cilat i trajtojnë më mirë.

Kryetari i Komunës së Shtimes njeheri edhe përfaqësuesi i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Naim Ismajli, tha ky institucion respekton vullnetin e të gjitha komunave në këtë aspekt, dhe është angazhuar që në kuadër të misionit të vet që komuna të jetë partnere që ti ngrisin performancat e tyre me qëllim që të jetë në nivel të shërbimit sa më të mirë të qytetarëve. "E para është që përmes grupit të ekspertëve të kompletohen dhe të ndryshohet legjislacionin në fuqi, më qëllim që komunat e Kosovës të jenë me atraktive për investimet e huaja, gjithmonë të vetëdijsh-

të punëtorëve, e që në Kosovë janë vetëm 16 ndërmarrje me investime të huaja direkte, të cilat kanë deri nga 250 punëtorë.

Punimet e konferencës u ndjekën nga disa kryetarët e komunave të Kosovës, zyrtarët e lartë të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Diasporës, përfaqësues të Odës Ekonomike të Kosovës, Odës Ekonomike Amerikane, si ajo etj, si dhe organizata Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ), përfaqësues të AMNVM, APIK, USAID, DFID, UNICEF, UNDP, KFOS, etj. AZHR - pesë zyrtar rajonale, Banka Botërore, Komision Evropian, Agjencioni i Privatizimit të Kosovës (AKP), etj.

Përveç konferenca të njëpasnjëshme që janë organizuar në UBT në kuadër të projektit në fjalë janë organizuar edhe vizita studimore nëpër komunat e Kosovës, ku partnerët e projektit kanë pas mundësi që për së afërmi t'i identifikojnë nevojat dhe kërkesat për përmirësimin e klimës së investimeve të huaja. Po ashtu si vazhdimësi e projektit u organizua edhe një vizitë studimore në Pragë të Republikës Çeke. Interesimi i palëve pjesëmarrëse në vizitë ishte për së afërmi ta shohin zhvillimin lokal, zhvillimin e zonave ekonomike, të parqeve, bizneseve, për të bërë promovimin e investimeve të huaja në rajonet e Republikës së Kosovës tek investitorët potencial çek.

UBT DHE MINISTRIA E DIASPORËS NDIHMOJNË NË ZHVILLIMIN E POLITIKAVE NDAJ MËRGIMTARËVE

18 nëntor - Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) prezantoi projektin "Perceptimi i Diasporës - 2011", organizuar në bashkëpunim dhe përkrahje nga Ministria e Diasporës e Republikës së Kosovës. Hulumtimi ka nxjerrë të dhëna të ndryshme sa i përket jetës së pjesëtarëve të diasporës, kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në diasporë, lidhjeve me familjet, perceptimin për përkujdesjen shtetërore ndaj tyre, lidhjet e tyre me atdheun, mundësitë për të vijuar mësimin plotësues në gjuhën amtare, planifikimet për hapje të biznesit në vendlindje e të tjera. Nga hulumtimi kanë dalë edhe kërkesa të ndryshme drejtuar institucioneve të Kosovës që sipas të intervistuarve mund të ndikojnë në përmirësimin e imazhit të vendit.

Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i cili e bëri publik hulumtimin "Perceptimi i Diasporës - 2011", tha se qëllimi i një analize të tillë ka qenë nxjerrja e ideve që vijnë nga diaspora e që ato të ndihmojnë institucionet e shtetit, shoqërinë në përgjithësi, në zhvillimin e politikave karshi mërgimtarëve.

Ministri i Diasporës i Republikës së Kosovës, Ibrahim Makolli, tha se ministria që ai drejton i mbështet hulumtimet e tilla me qëllim të krijimit të një pasqyre të përafërt për mënyrën e jetesës së mërgimtarëve tanë, perceptimin e tyre për shtetin amë, trajtimin e tyre institucional, vërejtjet dhe kërkesat e tyre.

"Konsiderojmë se hulumtime të tilla na ndihmojnë shumë në identifikimin e problemeve me të cilat ballafaqohet diaspora jonë në vendet ku jeton, e shohim se ku jemi ne si institucione shtetërore karshi nevojave të tyre dhe padyshim ato na nxisin që të avancojmë politikën tona ndaj diasporës", tha Ministri Makolli.



NEW TASTE MAX ENERGY



magnum

ENERGY DRINK
PIJE ENERGIJE

Produkt nga WILD Germany



Kush është Capital T ?

Capital-T emrin e vërtet e ka Trim Ademi. Studimet i vijon në UBT. Kënga e pare e Capital-T është «Shopping», jeton në Prishtinë. Capital T, edhe pse është i angazhuar me prezantime 'live' nëpër vende të ndryshme ku jetojnë shqiptarët, nuk e ka në plan të shkëputet për asnjë çast nga krijimet e reja, dhe për më detaje rreth këtij këngëtarit e ndjekim numrin e ardhshëm të gazetës "UBT News".



Edonisi po bëhet gati për shpërthimin e radhës

Edonis Kastrati, vazhdimisht bënë muzikë Hip Hop dhe e reprezenton grupin "E7 Clique"

Edonisi deri me tani i ka realizuar 7 Mixtape dhe diku rreth 150 këngë, dhe së shpejti pritet të dal me albumin më të ri dhe të parin i cili titullohet "Rapstar". "Do të incizohen rreth 30 këngë ku 20 prej tyre do te jene pjesë e albumit kurse 10 tjera do tw lansohen pastaj", tha Edonisi për gazetën "UBT News". Ai prej se ka filluar të mirret me muzikë gjatë gjithë kohës ka bashkëpunuar me producent më të njohur, po edhe për albumin në fjalë ka bashkëpunuar me këta si : UniKKatiL, BigBang Beatz, Èhite O.G, Strike Beatz, K-Master, Dj D Master etj.

Më konkretisht albumi në fjalë wshtw duke u ingjizuar nw "Daka Studio dhe FrontLine Music".

Kënga dhe spoti që e ka bërë të sukseshme Edonisin në botën e muzikës dhe në opinionin e gjerë është «Get Down», po ashtu edhe vetë reperti i hip hopit e pranin këtë fakt "Ishte spoti i parë që më afirmoj në televizionet tona, ka qene njw hap boom për mua".

Adonisi deri me tani i ka realizuar katër spote, dhe per momentin është duke punuar gjirimet e videoklipit të pestë. dhe rreth këtij klipi nuk fol më tutje kku thotë lë të mbete surprizë e fansave.

Adonisi përveq muzikës është edhe student në fakultetin Shkenca Kompjuterike në Universitetin për Biznes dhe Teknologji UBT edhe producent si dhe Sound Engineer ne nje nga televizionet tona.

FITUESI I KARATESË!

Herolind Nishevcu, student në UBT, po ashtu merret edhe me sportin e karatesë, ose më mirë të themi është nxënës i Shqipe Zogianit. Herolindi deri më tani, në çdo turne e ka përfaqësuar Kosovën, nganjëherë edhe Shqipërinë. Në çdo turne dhe shumë herë ka zënë vendin e parë nëpër shtetet më të zhvilluara të Evropës dhe botës, duke rrëmbyer gjithherë vendet e para si në Las Vegas (Ozawa Cup, po ashtu edhe Usa Olympics Junior Open), në Tokyo, në Qipro në Chicago Open, në Atlanda Cup, dhe vendin e parë në Australia Junior Open, kurse vendin e tretë në Istanbul Open, dhe shumë vende të para në shtetet ballkanike si në Bosnjë, Shqipëri, Mal të Zi, por rezultati më i rëndësishëm është kur merret vendin e parë në Mesdhe me Kombëtaren e Shqipërisë.

Përveç familjes dhe Ministrisë së Kulturës dhe Sportit, Herolindi nuk ka tjetër donator. Planet e tij janë që t'i përfundojë studimet dhe mendon të diplomojë sa më shpejt dhe t'i sjell Kosovës dhe Shqipërinë sa më shumë medalje dhe të organizojë disa mbrëmje rinore-studentore për studentët e UBT- së.



Blerimi e ndërron nofkën

Blerim Dervodeli, në estradën muzikore i njohur me nofkën 'DJ. Keep'ON', por së shpejti mendon ta ndryshojë nofkën me "Blerim Dervodeli DJ". "DJ. Keep'ON" kohëve të fundit ka bashkëpunuar me një pjesë të madhe të estradës së muzikës shqiptare si me Nora Istrefin, Dafina Zeqirin, Elvana Gjatën, Zanfina Ismajlin etj, por gjithashtu merret edhe me HIP-HOP & RNB.

"Si DJ kam oferta të shumta të cilat jam duke i shqyrtuar, pikërisht për koncerte, por ende nuk kam vendosur se me kë do bashkëpunoj për kohën në vijim, por për momentin jam duke bashkëpunuar me 'DJ. RNL', i cili jeton në Austri, dhe jam duke punuar me disa këngë si RMX, MIX, të cilat për një kohë të shkurtër priten të publikohen", tha ai.

Blerimi deri tash ka vetëm një videospot, i cili mban titullin 'No Life, No Music I'm DJ'.

Ai për gazetën "UBT News" citon: "Muzikën e ndjej dhe e bëj me plot forcë dhe qejf". Përpos muzikës, merret edhe me studime: studion në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, gjithashtu merret edhe me sport.



Kico bashkëpunon me Dafinën dhe Aurelen

Arijanin Haxhixhemajli- Kico, përveç si kompozitor e gjejmë edhe në UBT, i cili studion në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi. Ariani një pjesë të kohës e kalon në studion e vet duke komponuar këngë të zhanreve të ndryshme si Hip hop, RMB etj, dhe një prej këngëve që ka kompozuar po të zhanrit në fjalë dhe që ka lansuar kohëve të fundit është kënga "Lej fllëshat" të rap këngëtarit Mc kresha që ishte njëra ndër këngët më të dëgjura tek të rinjtë kosovarë. Me pastaj ka komponua këngën "My swag Dafina Zeqiri", të këngëtares Dafina Zeqiri. Po ashtu kohëve të fundit sipas burimeve që kemi Kico është ka bashkëpunon edhe me këngëtares nga Shqipëria Aurela Gacaj, dhe thuhet që kënga është në përfundim, nga Ariani është kompozuar, por ende nuk është vendosur për titull por pritet së shpejti të lansohet në treg.



10 YEARS

LEADERSHIP AND INNOVATION

Education • Research • Training • Consulting
2001/2011